



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Inxhinieri
Elektrike”**

i

Institucionit të Arsimit të Lartë “Albanian University”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Asoc. Genci Sharko


2. Dr. Lindita Dhano

Nëntor/2022

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Për programin e studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Inxhinieri Elektrike”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti Privat “Albanian University”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Inxhinierive
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Inxhinieri Elektrike”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASH Nr. 479, datë 10.10.2012
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Ndryshime në masën 20 % me VS Nr. 19, datë 15.09.2017, konfirmuar me shkresë të MASR Nr. 969/2 Prot., datë 05.06.2018
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	UMASR Nr. 552, datë 01.11.2017
7	Urdhëri/VBA i akreditimit:	VBA Nr. 40, datë 19.05.2017 VBA Nr. 42, datë 13.07.2018
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite / 6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	16 PAE / 13 PAK
18	Numri i studentëve:	120 studentë
19	Komente / të tjera:	



TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti Privat "Albanian University" ka filluar aktivitetin akademik në vitin 2014, pas licensimit të tij me VKM nr. 194, datë 10.04.2014. Me Urdhërin e MAS Nr. 52, datë 05.02.2016 "Për riorganizimin institucional të Universitetit Privat "Albanian University" dhe Urdhër i MAS Nr. 596, datë 21.12.2016 "Për miratimin e Statutit të Universitetit "Albanian University" të Ministrit të Arsimit Sporteve dhe Rinisë, është realizuar hapja e njësisë kryesore "Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë". Akreditimi i fundit për institucionin e organizuar me 3 njësi kryesore është kryer me Vendim BA Nr. 01, datë 24.01.2020 "Për Akreditimin Institucional të Institucionit të Arsimit të Lartë, Universiteti Privat "Albanian University", me kohëzgjatjen prej 3 (tre) vite. Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të Institucionit është 23/01/2023.

Programi i studimit aktualisht në proces vlerësimi për riakreditim, Bachelor në "Inxhinieri Elektrike" është në varësi të Departamentit të Inxhinierive, në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike.

Programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri Elektrike" është licencuar me Urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës Nr. 479, datë 10.10.2012, si dhe është akredituar me VBA Nr. 40, datë 19.05.2017 dhe VBA Nr. 42, datë 13.07.2018.

Programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri Elektrike" është program studimi i ciklit të parë dhe i përket nivelit të 6-të të kualifikimit sipas kornizës Shqiptare të Kualifikimit. Kohëzgjatja normale e studimeve është 3 vite, të cilave u përkojnë 180 kredite. Programi zhvillon mësimdhënien në gjuhën shqipe. Forma e studimit është me kohë të plotë. Aktualisht programi i studimit ka hyrë në procesin e riakreditimit. Regjistrimi i formës së diplomës është bërë me Urdhër të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 552, datë 01.11.2017.

Raporti i Vlerësimit të Jashtëm (RVJ) është hartuar në vijim të procedurave për riakreditim të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Inxhinieri Elektrike", të ofruar nga Albanian University.

Në hartimin e këtij Raporti, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) është mbështetur në dokumentacionin e Dosjes së Vetëvlerësimit (DVV) të përgatitur nga Grupi i Vetëvlerësimit për këtë program studimi, në konstatimet, gjetjet dhe shënimet e mbajtura gjatë takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në Institucion.

SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Në akreditimin e mëparshëm periodik të këtij programi studimi me VBA Nr. 42, datë 13.07.2018, janë lënë për përmbushje disa rekomandime nga Bordi i Akreditimit. Në vijim paraqiten rekomandimet e lëna dhe përmbushja e tyre nga AU:

- 1. Institucioni, të rekrutojë staf të ri akademik, me grada shkencore dhe tituj akademik, për të reduktuar ngarkesën akademike të stafit akademik aktual dhe rishpërndarjen më efektive të saj.**

AU bën përpjekje serioze për përmbushjen e këtij rekomandimi, pasi referuar Evidencës R.1.a,b,c në DVV dhe nga takimet në institucion me Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe Përgjegjësen e Departamentit, u konstatua se dy herë në vit shpallen publikisht (në fillim të vitit akademik dhe përpara fillimit të semestrit të dytë) nevojat për staf të ri akademik me tituj dhe grada shkencore, sipas specifikave të çdo programi studimi. Institucioni ka hasur vështirësi në këtë proces sepse kandidatët të cilët plotësojnë këto kritere, kanë qenë të paktë. PAE me gradën shkencore “Doktor” i rekrutuar në vitin e fundit të periudhës në shqyrtim është me moshë mbi 65 vjeç, të tjerët janë Msc. Për sa më lart, GVJ vlerëson se ky rekomandim përmbushet kryesisht.

- 2. Institucioni, të hartojë politika dhe procedura rekrutimi të posaçme për perspektivën e zëvendësimit të stafit të kualifikuar ekzistues në moshë të avancuar, si dhe mbështesë kualifikimin e mëtejshëm të stafit ekzistues në Institucion, për të garantuar vijueshmërinë e mbulimit të programit të studimit sipas standardeve në fuqi.**

Personeli akademik efektiv në Departamentin e Inxhinierive, përgjegjës për këtë program studimi ka bërë përpjekje për rritjen profesionale në drejtim të fitimit të titujve akademike e gradave shkencore (1 PAE ka fituar titullin akademik Prof.Asoc, 1 PAE ka fituar gradën shkencore “Doktor”). [Evidencë: Tabela 2 në Aneks RVB]. AU ka zbatuar në vazhdimësi procedura rekrutimi PAE në zbatim të politikës së tërheqjes së stafit akademik me tituj e grada shkencore dhe moshë relativisht të re, megjithëse ka hasur në vështirësi. Gjithashtu, DI ka aplikuar në hapjen e një programi “Doktoratë” për mbështetjen e personelit akademik efektiv në marrjen e gradave shkencore [Evidencë R.2]. Për sa më lart, GVJ vlerëson se ky rekomandim përmbushet plotësisht.

- 3. Institucioni, të marrë masa për lidhjen e marrëveshjeve të reja specifike të bashkëpunimit dhe konsolidimin e atyre ekzistuese me Institucione në fushën e inxhinierisë elektrike, në kuadër të realizimit të praktikave mësimore të studentëve të këtij programi studimi.**


AU ka 15 marrëveshje bashkëpunimi me subjekte shtetërore e private të mjaftueshme për realizimin me sukses të praktikave mësimore të studentëve të programit të studimit

Bachelor në “Inxhinieri Elektrike” [Tabela 5, Evidencë R.3]. AU ka nënshkruar marrëveshje me aktorë të rëndësishëm në fushën e shërbimeve elektrike, siç është ajo me ERE [R.3 Marrëveshje ERE - 18.02.2022]. Për sa më lart, GVJ vlerëson se ky rekomandim përmbushet plotësisht.

4. Në kuadër të rekrutimit të stafit të ri akademik dhe rishpërndarjes së ngarkesës akademike të programit të studimit, të parashikohet dhe përcaktimi i titullarëve të lëndëve kryesisht nga stafi akademik me kohë të plotë.

Institucioni dhe DI ka bërë përpjekje për të realizuar përcaktimin e titullarëve të lëndëve sipas përcaktimeve ligjore, por disa prej lëndëve (Makina elektrike 1, Makina elektrike 2, Teknikë sigurimi, Praktika mësimore, Sistemet elektrike të fuqisë, Ndriçimi elektrik) titullari i lëndës ka gradën shkencore “Doktor”. Vihet re se titullarët e shumicës së lëndëve janë me tituj akademik “Prof. As” dhe “Prof” nga personeli akademik PAK. Për sa më lart, GVJ vlerëson se ky rekomandim përmbushet kryesisht.

Në tërësi, rekomandimet e lëna nga Bordi i Akreditimit janë përmbushur kryesisht.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Ky raport është përgatitur nga Grupi i Ekspertëve të Jashtëm të ngritur nga ASCAL për akreditimin e programeve në Universitetin Privat “Albanian University”, në zbatim të ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, ku janë përcaktuar kodi i cilësisë dhe standardet shtetërore të cilësisë për vlerësimin dhe akreditimin e programeve të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve.

Ekspertët fillimisht vlerësuan dokumentacionin e vetëvlerësimit të dorëzuar nga Universiteti Privat “Albanian University”, në kuadër të procedurës së aplikimit për akreditim të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Inxhinieri Elektrike”, e përbërë nga 110 dokumenta në total.

Ekspertët sipas një agjende të hartuar në funksion të procesit të vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Inxhinieri Elektrike” kanë realizuar vizitën në datat 5 dhe 6 korrik 2022 në Universitetin Privat “Albanian University”, sipas veprimtarive të parashikuara në agjendë, në funksion dhe plotësim të procesit të vlerësimit të jashtëm nga ekspertët. Gjatë këtij procesi, GVJ u shoqërua nga Koordinatorët Teknikë të ASCAL, Znj. Juna Mengri dhe Zj. Ersi Dako.

Grupi i ekspertëve ka vijuar punën për hartimin e një raporti të integruar të vlerësimit të jashtëm të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Inxhinieri Elektrike”, bazuar në gjetjet dhe konstatimet e zbatimit të kriterëve të standarteve shtetërore të cilësisë nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Albanian University”.

Më datë 07.11.2022, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 24/44 Prot., datë 07.11.2022, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL përcolli komentet, përmes AMS, më datë 11.11.2022 dhe me shkresë zyrtare Nr. 625/1 Prot., datë 10.11.2022.

GVJ, pasi u njoh me komentet e Institucionit mbi Draft-Raportin, sqaron si në vijim:

- 1. GVJ tek Standardi II.4, Kriteri 6:** Nga shqyrtimi i syllabuseve, evidentohet se një pjesë e literaturës në syllabuse nuk është e 5 viteve të fundit (psh. Elektroteknikë I, Makinat Elektrike, Prodhimi, shpërndarja, përdorimi i energjisë elektrike etj.).

Komenti nga IAL: Literatura e përdorur në syllabuset e këtyre lëndëve është ajo e disponueshme aktualisht në treg në gjuhën shqipe. Jemi vënë në dijeni, për lëndën Makina elektrike pritet të bëhet e disponueshme së shpejti në librari literaturë e përditësuar. Do të kujdesemi të përditësojmë syllabuset në përputhje me të dhe në vijim ta bëjmë të disponueshme në bibliotekë edhe për studentët.

Komenti nga GVJ:

GVJ vlerëson përpjekjet e Institucionit dhe hapat e ndërmarra për përmirësimin e literaturës së lëndëve të programit të studimit Bachelor në “Inxhinierinë Elektrike”, por GVJ rikonfirmon gjetjen e vendosur në raport.

2. **GVJ tek Standardi IV.2, Kriteri 2:** Mëgjithë përpjekjet e bëra nga institucioni dhe stafi, vërehet numër jo në nivele të larta i publikimeve prej stafit PAE të programit të studimit. Gjatë tre viteve të fundit akademike, kanë patur një rënie gati me 50 % vit pas viti.

Komenti nga IAL: Nisur nga të dhënat e tabelës publikimet e PAE ndryshojnë pak ndër vite – 38 (v.a. 2018-2019), 41 – rritje me 8% krahasuar me vitin paraardhës (v.a. 2019-2020), 31 – rënie me 25% krahasuar me vitin paraardhës (v.a. 2020-2021). Shtojmë këtu, që stafi i Departamentit të Inxhinierive ka punuar në drejtim të rritjes së cilësisë krahas sasisë së punimeve shkencore.


Komenti nga GVJ:

Në vlerësimin e GVJ në pasqyrimin e të dhënave për publikimet ishte marrë në analizë numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga Departamenti/Fakulteti dhe IAL, për programin e studimit, referuar tabelës 19 në tabelat përmbledhëse bashkëngjitur RVB-së dhe jo numri i publikimeve. Për sa më lart, GVJ pranon komentin e IAL-së dhe pasqyron në këtë standard të dhënat e sakta, sikurse cituar nga IAL në koment dhe pasqyruar në tabelën e sipërcituar.

3. **GVJ tek Standardi IV.6, Kriteri 2:** Vihet re një rritje e të ardhurave nga grantet e fituara prej personelit akademik të programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Elektrike” në kuadër të projektit dypalësh midis Shqipërisë dhe Turqisë “*Disenjimi dhe konstruktimi i dorës robotike të komanduar për lëvizje të ndryshme*”, projekt i fituar në bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës, Hasan Prishtina, financuar nga AKKSHI.

Komenti nga IAL: Të saktësohet “*projektit dypalësh midis Shqipërisë dhe Kosovës*”.


Komenti nga GVJ: GVJ konfirmon se në këtë fjali është bërë një lapsus në formulim, prandaj GVJ pranon komentin e IAL dhe pasqyron ndryshimin përkatës në fjali.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Inxhinieri Elektrike”

I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE

Standardi I.1				
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga Universiteti Privat “Albanian University”, rregullores së programit të studimit, GVJ vlerëson se programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Inxhinieri Elektrike”, ofruar prej Departamentit të Inxhinierive është në përputhje me misionin e AU shprehur në statutin e institucionit dhe nuk bie ndesh me interesat kombëtare. Ky program studimi synon formimin e inxhinierëve elektrikë në përputhje me kërkesat e tregut të punës. <i>Evidencë 1.2 Statuti Albanian University; Evidencë 1.5.a Plani strategjik institucional 2017 – 2022.</i>			
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Sipas planit strategjik të AU, GVJ vlerëson se programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Inxhinieri Elektrike” ruan dhe konsolidon vlerat akademike e kulturore kombëtare. Ai synon t’u japë studentëve një edukim cilësor, kontribut në kërkim të qëndrueshëm në përdorimin e arritjeve më të mira të shkencës. <i>Evidencë 1.2 Statuti Albanian University; Evidencë 1.5.a Plani strategjik institucional 2017 – 2022.</i>			
Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Inxhinieri Elektrike” është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe me politikat e zhvillimit të Institucionit, në lidhje me përgatitjen e profesionistëve në fushën e Inxhinierisë Elektrike. <i>Evidencë 1.5.a Plani strategjik institucional 2017 – 2022.</i>			
Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga AU rezulton se programi i ciklit të parë Bachelor në “Inxhinieri Elektrike” është ngritur dhe hapur bazuar në studimin e tregut. Departamenti i Inxhinierive kujdeset për përditësimin e kurrikulës që ofron, bazuar kjo në studimin e vazhdueshëm të tregut. <i>Evidencë 1.4.b Raport mbi studimin e tregut - DI Dhjetor 2019-2021.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Standardi I.2


Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Elektrike” është konceptuar në harmoni me strategjinë e institucionit i cili ka si objektiva strategjike cilësinë dhe performancën akademike. Përbushja e misionit të AU planifikohet të realizohet edhe duke siguruar shumëllojshmëri të ofertave të formimit në përputhje me nevojat e zhvillimit industrial perspektiv të vendit. <i>Evidencë 1.5.a Plani strategjik institucional 2017 – 2022; Evidencë 2.1.b Plani mësimor BSc. IE - 04.2019.</i>			
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Statuti i “Albanian University” përcakton qartë drejtimit prioritar akademike të tij. Drejtimit prioritar akademike të universitetit përputhen me fushat e studimit të programit të ciklit të parë Bachelor në “Inxhinieri Elektrike”, Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike dhe Departamentit të Inxhinierive, prej nga varet programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Elektrike”. <i>Evidencë 1.2 Statuti Albanian University; Evidencë 1.5.a Plani strategjik institucional 2017 - 2022.</i>			
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Elektrike” emërtohet, organizohet, si dhe ka përmbajtje në përputhje me fushën akademike të Inxhinierisë Elektrike, e cila është një prej drejtimeve akademike të “Albanian University”. <i>Evidencë 1.2 Statuti Albanian University; Evidencë H.1 Rregullore mësimorë BSc. IE - 20.03.2019.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor “Inxhinieri Elektrike” realizohet në përputhje me objektivat e përcaktuara prej nga rrjedhin edhe qartësisht objektivat e mësimdhënies. Bazuar në rregulloren e programit, objektivat formuese përfshijnë pajisjen e studentëve me njohuri të avancuara në fushën e Inxhinierisë Elektrike. Këto objektiva janë pasqyruar tek kurrikula, organizimi i planit mësimor, ndarja e moduleve në vite, syllabuset, shpërndarjen e orëve teorike/praktike, laboratorët dhe praktikat profesionale. GJV, nga shqyrtimi i dokumentacionit, vlerëson se programi i studimit është hapur në përputhje me kërkesën e tregut për profesionin e Inxhinierit Elektrik.



	<i>Evidencë H.1 Rregullore mësimore BSc. IE - 20.03.2019.</i>			
Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.	Institucioni ka realizuar studimin për tregun e punës në vitin 2019 dhe 2021. Në këtë studim përfshihen të dhëna mbi punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna tabelore përmbledhëse për punësimin real të studentëve të programit të ciklit të parë Bachelor në “Inxhinieri Elektrike”. <i>Institucioni nuk ka realizuar deri më tani ndonjë studim mbi tregun ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron.</i> <i>Evidencë 1.4.b Raport mbi studimin e tregut - DI - Dhjetor 2021.</i>			
Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.	Objektivat formuese, përmbajtja dhe struktura e programit të studimit mundësojnë rezultate të mira të të nxënit duke garantuar përfundimin e dijeve, aftësive e kompetencave sipas nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve. Studentët që diplomohen në këtë program studimi mund të punojnë si: inxhinier elektrik, etj. <i>Evidencë H.1 Rregullore mësimore BSc. IE - 20.03.2019.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.4	
Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.	Nga vlerësimi i dokumentacionit dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se AU ka përvojë dhe eksperiencë në fushën akademike, kapacitetet në infrastrukturë dhe struktura ndihmëse universitare. Personeli akademik efektiv (PAE) i angazhuar në realizimin e programit të studimit, në vitin akademik 2021-2022 përbëhet nga: 2 Profesorë të Asociuar, 7 Lektorë me gradën Doktor dhe 7 Asistent-Lektorë me gradën Msc., në total 16 PAE, ndërsa personeli akademik me kontratë (PAK) përbëhet nga: 1 Profesor, 4 Profesorë të Asociuar dhe 8 Lektorë me gradën Doktor, në total 13 PAK. Departamenti i Inxhinierive, si njësi bazë përgjegjëse për ofrimin e këtij programi studimi, ka raport stafi akademik PAE/PAK si 17/19, me kualifikimin si në vijim: personeli akademik PAE: 1 Prof. As., 7 Dr., dhe 9 Msc.; personeli akademik PAK: 2 Prof. Dr., 5 Prof.As., 11 Dr., dhe 1 Msc. <i>Evidencë 2.8.d Ngarkesa mësimore stafi akademik BSc. IE - 2021 – 2022; Evidencë 2.9 CV stafi akademik dhe personeli ndihmës akademik (laborant) BSc. IE - v.a. 2021 – 2022; Evidencë Aneks tabela - RVB - BSc. IE – 2022.</i>
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën	Njësi kryesore, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, ofron programe studimi në fushën e inxhinierisë elektrike që prej vitit 2012. Drejtimet kërkimore shkencore të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe

<p>akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Ekonomike janë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore. Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Elektrike”, i ofruar nga Departamenti i Inxhinierive, ka si fushë të përgjithshme fushën e inxhinierisë elektrike të përputhur me fushën akademike dhe shkencore të njësisë kryesore. <i>Evidencë H.1 Rregullore mësimore BSc. IE - 20.03.2019.</i></p>			
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>GVJ konstaton se fusha e përgjithshme e programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Elektrike” është në përputhje me aktivitetin mësimor-kërkimor të Departamentit të Inxhinierive si njësi bazë për këtë program studimi, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane pranë Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike të AU. <i>Evidencë H.1 Rregullore mësimore BSc. IE - 20.03.2019.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

<p>Standardi I.5 Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Ndarja e detyrave mes njësisë e personelit përcaktohet nga institucioni në rregulloren tij dhe në rregulloren e njësisë kryesore. Nga vlerësimi rezulton se Departamenti i Inxhinierive ofron programin e studimit Bachelor “Inxhinieri Elektrike”, i cili ka një kohëzgjatje 3-vjeçare dhe në total përmban 180 kredite. Vërehet një bashkëpunim i ngushtë me të gjitha strukturat e institucionit si: Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë, Sekretaria mësimore, Arkiva dhe Protokolli, Zyra e Burimeve Njerëzore, Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave, Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, Zyra e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë, etj. dhe departamentet e tjera në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike të “Albanian University”, gjë që çon në përmirësimin e efektivitetit të këtij programi studimi. <i>Evidencë 1.3 Rregullore Albanian University; Evidencë 6.8.e Rezultatet e pyetësorit drejtuar personelit akademik për mësimin online v.a. 2020 - 2021 - Sem. I; Evidencë 6.8.a Rezultatet e pyetësorit drejtuar studentëve për mësimin online v.a. 2019 – 2020; Vizita në Institucion, takimi me përgjegjës të departamentit.</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos</p>	<p>Universiteti Privat “Albanian University” ka bashkëpunime ndër-institucionale me institucione shtetërore dhe IAL brenda vendit, si dhe me</p>

<p>marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>kompani dhe zyra, pjesë e komunitetit të biznesit ose tregut të punës. Realizimi i praktikave profesionale mbetet një ndër bashkëpunimet kryesore me këto institucione. Me anë të këtyre bashkëpunimeve AU synon gjithashtu krijimin e lidhjeve midis universitetit dhe aktorëve të tregut të punës në funksion të punësimit të studentëve, por edhe për të qenë më pranë nevojave të tregut të punës dhe reflektimit të tyre në programin e studimit. Departamenti i Inxhinierive ka nënshkruar mbi 30 marrëveshje specifike për programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Elektrike”, midis 187 marrëveshjeve në total që ka nënshkruar njësia kryesore, si me OSHEE, OST, ITE group, Albamachinery, GreenTech energz systems HEC Fierzë, ERE etj.</p> <p><i>Evidencë Aneks tabela - RVB - BSc. IE – 2022.</i></p>			
<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Departamenti i Inxhinierive, përgjegjës për programin e studimit, ka realizuar një raportim analitik të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve, i cili i është përcjellë njësisë kryesore dhe NJSBC.</p> <p>Ky raport është për realizimin e përfitimeve nga praktikatat mësimore/profesionale për të gjithë departamentin, përfshirë edhe programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Elektrike”.</p> <p><i>Evidencë 1.1.c Raporti vjetor - DI - v.a. 2020 – 2021; Evidencë 1.8 Raporti analitik marrëveshje praktika – 2021.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>GVJ konstaton se procedura e zhvillimit të praktikave profesionale është e rregulluar nëpërmjet udhëzuesit për zhvillimin e praktikës. Në të janë parashikuar si procedurat që duhet të ndiqen, ashtu edhe roli i aktorëve dhe njësisë të ndryshme të përfshira në këtë proces. Departamenti i Inxhinierive ka nënshkruar mbi 30 marrëveshje specifike për programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Elektrike”.</p> <p><i>Evidencë Aneks tabela - RVB - BSc. IE – 2022; Evidencë H.1 Rregullore mësimore BSc. IEk - 20.03.2019.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i materialeve në dosjen e akreditimit dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se AU organizon takime dhe aktivitete të tjera me studentët e diplomuar përmes rrjetit ALUMNI, por nuk evidentohet organizim trajnimesh pas diplomimit.</p> <p><i>Vizita në Institucion, takimi me Zyrën e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës dhe NJBSC .</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Elektrike” organizohet në lëndë të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ky program studimi ka një kohëzgjatje normale 3 vite dhe në total 180 kredite.</p> <p><i>VKM nr. 41, datë 24. 1. 2018; VKM Nr. 879, datë 18.12.2019; Evidencë H.1 Rregullore mësimore BSc. IE - 20.03.2019; Evidencë 2.1.b Plani mësimor BSc. IE - 04.2019.</i></p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.</p>	<p>Programi i studimit. nëpërmjet moduleve dhe lëndëve të ofruara, krijon mundësinë e formimit të shprehive të veçanta. Studimi i tregut i kryer ka evidentuar disa specialitete për të cilat formohen studentët e këtij programi. Disa nga profesionet dhe specialitetet për të cilat formohen studentët e këtij programi janë: inxhinier elektrik, automatizimi i ndërtesave, fotovoltaike dhe energjitë e rinovueshme, projekttime industriale, etj.</p> <p><i>Evidencë H.1 Rregullore mësimore BSc. IE - 20.03.2019; Evidencë 2.1.b Plani mësimor BSc. IE - 04.2019; Evidencë R.4 Syllabuset e lëndëve BSc. IE - 2021 – 2022.</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe intervistave gjatë vizitës në institucion GVJ konstaton se programi i studimit thëllon njohuritë e studentëve në fushën e Inxhinierisë Elektrike, ku një vend të konsiderueshëm në program zë të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve të fushës së automatizimit të industrisë.</p> <p><i>Evidencë H.1 Rregullore mësimore BSc. IE - 20.03.2019; Evidencë R.4 Syllabuset e lëndëve BSc. IE - 2021 – 2022; Vizita në Institucion, takimi me stafin akademik.</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Elektrike” ka ndër objektivat kryesorë t’u mundësojë studentëve njohuritë më kryesore dhe më bashkëkohore të nevojshme në fushën e automatizimit industrial. Gjithashtu programi synon që studentët të jenë në gjendje të përcaktojnë zgjidhje të proceseve teknologjike në fushën e inxhinierisë elektrike duke shfrytëzuar analiza dhe kriteret të aplikuar në këtë fushë për sisteme të tilla. GVJ konstaton se objektivat formuese përmbushen mirë.</p> <p><i>Evidencë 2.1.b Plani mësimor BSc. IE - 04.2019; Evidencë R.4 Syllabuset e lëndëve BSc. IE - 2021 – 2022; Evidencë H.1 Rregullore mësimore BSc. IE - 20.03.2019.</i></p>

<p>Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit përcakton në mënyrë të detajuar shpërndarjen e krediteve midis lëndëve, kategorizimin e lëndëve, elementët e mësimdhënies etj., të cilat rezultojnë të paraqitura në përputhje me akte ligjore e nënligjore në fuqi. Për të gjitha lëndët/modulet janë dhënë ngarkesa në kredite, format e ndryshme të mësimdhënies, orët mësimore në auditor dhe ngarkesa jashtë auditorit, kategoria të cilës i përket, etj.</p> <p><i>Evidencë H.1 Rregullore mësimore BSc. IE - 20.03.2019; Evidencë 2.1.b Plani mësimor BSc. IE - 04.2019.</i></p>			
<p>Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Nga shqyrtimi i programit mësimor dhe syllabuseve rezulton se ky program studimi ka një ndarje të qartë të lëndëve sipas kategorive të përcaktuara dhe secila prej tyre ka të përcaktuar ngarkesën përkatëse në kredite duke e respektuar totalin vjetor prej 60 kreditesh.</p> <p>GVJ konstaton se lëndët/modulet janë grupuar sipas veprimtarive formuese në përputhje me Ligjin 80/2015 dhe VKM nr. 41, dt. 24.01.2018, e ndryshuar.</p> <p>Programi ka të përcaktuara veprimtaritë formuese, kryesisht leksione dhe seminare. Gjatë vizitës GVJ konstatoi laboratorët mbështes për lëndët laboratorike ku mundësohet dhe praktikimi i njohurive në praktikë.</p> <p><i>GVJ konstaton se shpërndarja e tyre është në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, por sugjeron shtimin e orëve laboratorike në veprimtaritë formuese të programit të studimit.</i></p> <p><i>Evidencë H.1 Rregullore mësimore BSc. IE 20.03.2019; Evidencë 2.1.b Plani mësimor BSc. IE - 04.2019; Evidencë R.4 Syllabuset e lendeve BSc. IE 2021-2022; Vizita në Institucion, takimi me përgjegjës të departamentit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi II.2 Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Elektrike” është licencuar me Urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës Nr. 479, datë 10.10.2012. Pas këtij licencimi, programi i studimit i është nënshtruar procesit të akreditimit për herë të parë, në përfundim të të cilit është akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 40, datë 19.05.2017, si dhe procesit të akreditimit periodik, në përfundim të të cilit programi është akredituar me VBA Nr. 42, datë 13.07.2018, me kohëzgjatje prej 4 (katër) vite akademike.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Përgjegjësia për ecurinë dhe zhvillimin e programit në përputhje me objektivat e tij është e përgjegjës të departamentit.</p> <p>Koordinatorët e grupeve mësimore koordinojnë përmbajtjen e syllabuseve të lëndëve të grupit mësimor, rishikimin etj., si dhe janë përgjegjës për ecurinë e praktikave profesionale.</p>

<p>Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>Koordinatori për studentët koordinon marrëdhëniet mes studentëve dhe stafit, kryen këshillimin e studentëve në lidhje me kurrikulën dhe raporton për problematika të studentëve në departament dhe tek përgjegjësi i departamentit.</p> <p><i>Evidencë H.1 Rregullore mësimore BSc. IE - 20.03.2019; Evidencë 2.3.a Koordinatorët e grup lëndëve DI; Evidencë 2.2 Rregullore Departamenti - VS. 20 - 30.07.2021.</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike dhe Departamenti i Inxhinierive përmbushin detyrimet ligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p> <p>Në këtë fakultet janë tre njësi bazë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Art Dizajnit; 2. Departamenti i Shkencave Ekonomike; 3. Departamenti i Inxhinierive. <p>Secila prej njësive bazë, përfshirë dhe Departamentin e Inxhinierive, përgjegjës për këtë program studimi, për të gjitha vitet akademike prej akreditimit të mëparshëm, ka patur dhe ka në përbërje të paktën 7 personel akademik efektiv (PAE), ku të paktën 3 janë me tituj dhe grada, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> <p><i>Evidencë Aneks tabela - RVB - BSc. IE – 2022.</i></p>
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>Përbërja e Departamentit të Inxhinierive, përgjegjës për këtë program studimi, paraqitet si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Për vitin akademik 2018-2019: 19 PAE, me kualifikimin 8 Dr., dhe 11 Msc. (3 Dr. në proces) dhe 16 PAK, me kualifikimin 1 Prof. Dr., 7 Prof. As., 6 Dr., dhe 2 Msc. (1 Dr. në proces); – Për vitin akademik 2019-2020: 16 PAE, me kualifikimin 7 Dr., dhe 9 Msc. (3 Dr. në proces) dhe 18 PAK, me kualifikimin 1 Prof. Dr., 6 Prof. As., 9 Dr., dhe 2 Msc. (1 Dr. në proces); – Për vitin akademik 2020-2021: 15 PAE, me kualifikimin 7 Dr., dhe 8 Msc. (1 Dr. në proces) dhe 17 PAK, me kualifikimin 2 Prof. Dr., 5 Prof. As., 7 Dr., dhe 3 Msc. (2 Dr. në proces); – Për vitin akademik 2021-2022: 17 PAE, me kualifikimin 1 Prof. As., 7 Dr., dhe 9 Msc., dhe 19 PAK, me kualifikimin 2 Prof. Dr., 5 Prof. As., 11 Dr., dhe 1 Msc. <p><i>Evidencë Aneks tabela - RVB - BSc. IE – 2022.</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Nga shqyrtimi i të dhënave të paraqitura të pasqyruara edhe në kriterin më lart, konstatohet se njësia kryesore dhe njësia bazë përgjegjëse për programin, përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik. Kategoria “Profesor” ka moshë mesatare të lartë, mbi 55- 65 vjeç.</p> <p><i>Evidencë Aneks tabela - RVB - BSc. IE – 2022.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi II.3

Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	<p>Departamenti i Inxhinierive disponon dhe ka vënë në dispozicion të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit si: Rregulloren, programin mësimor, syllabuset, orarin, ngarkesën e stafit akademik, etj. Dosja e plotë e çdo viti mbahet në departamentin përkatës.</p> <p><i>Evidencë 2.8.d Ngarkesa mësimore stafi akademik BSc. IE 2021 – 2022; Evidencë 2.1.b Plani mësimor BSc. IE - 04.2019; Evidencë R.4 Syllabuset e lëndëve BSc. IE 2021-2022.</i></p>
Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	<p>GVJ konstaton se veprimtaritë formuese janë shpërndarë në përputhje me VKM nr. 41, dt. 24.01.2018, e ndryshuar. Veprimtaritë formuese kanë një shpërndarje si në vijim:</p> <p>A. Lëndë Bazë: 33 ECTS / 18.33% (sipas VKM 15%-20%); B. Lëndë Karakterizuese: 94 ECTS / 52.22% (sipas VKM 50%- 55%); C. Lëndë Ndërdisciplinore: 25 ECTS / 13.89% (sipas VKM 12%-15%); D. Lëndë Plotësuese (Praktika): 22 ECTS / 12.22% (sipas VKM 10%-15%); E. Detyrime Përmbyllëse: 6 ECTS / 3.3% (sipas VKM 3%- 5%).</p> <p>Në syllabuset e lëndëve paraqitet qartë ndarja e elementëve të lëndës (leksion, seminar).</p> <p><i>Evidencë H.1 Rregullore mësimore BSc. IE - 20.03.2019; Evidencë Aneks tabela - RVB - BSc. IE – 2022; Vizita në Institucion, takimi me përgjegjës in e departamentit.</i></p>
Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të përcjellë nga AU, shprehet qartë shpërndarja e krediteve në gjashtë semestra dhe për secilën lëndë apo veprimtari brenda programit, sipas parashikimeve në Ligjin 80/2015, VKM 41, datë 24.01.2018 (ndryshuar me VKM 879, dt. 18.12.2019 dhe VKM 185, dt. 25.3.2021). Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Elektrike”, kohëzgjatja e programit të studimit (3 vite akademike), me nga 2 semestra dhe 60 ECTS për çdo semestër, shpërndarja e krediteve për komponentët e ndryshëm të procesit mësimor, janë në përputhje me sistemin shqiptar dhe evropian të studimeve universitare të ciklit të parë.</p> <p><i>Evidencë H.1 Rregullore mësimore BSc. IE - 20.03.2019; Evidencë 2.1.b Plani mësimor BSc. IE - 04.2019.</i></p>
Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në	<p>GVJ konstaton se plani mësimor përmban informacionet për ngarkesën mësimore, orët në auditor dhe jashtë auditorit. Frekuentimi, ndjekja e programit dhe mënyra e vlerësimit të dijeve përcaktohen në rregulloren e</p>



auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	<p>programit dhe syllabuset. Në syllabuset e lëndëve jepet informacion në lidhje me temat mësimore në leksione dhe në seminare, orët faktike për secilën prej temave, detyrimet lidhur me lëndën, etj.</p> <p><i>Evidencë H.1 Rregullore mësimore BSc. IE - 20.03.2019; Evidencë R.4 Syllabuset e lendeve BSc. IE 2021-2022.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se Rregullorja e programit të studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme që lidhen me kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve</p> <p>Kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit jepen në Rregulloren mësimore. Kandidatët fitues përzgjidhen nga Komisioni <i>Ad-Hoc</i>, i propozuar nga Departamenti dhe i miratuar nga Dekanati. Transferimi i studentëve në programe studimi të njëjta ose të afërta, vendase ose të huaja, dhe ekuivalentimi i studimeve rregullohen me dokumentin e Rregullores së regjistrimeve dhe transferimeve.</p> <p><i>Evidencë H.1 Rregullore mësimore BSc. IE - 20.03.2019; Evidenca 2.4 Rregullore e regjistrimeve dhe transferimeve - VS 25 - dt. 25.06.2020.</i></p>			
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se syllabuset e lëndëve janë të paraqitura në strukturë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi.</p> <p>Programet lëndore hartohen nga titullari i lëndës, sipas modelit të paraqitur në VKM nr. 41, dt. 24.01.2018, e ndryshuar. Në fillim të çdo semestri pedagogu i njeh studentët me programin lëndor dhe veprimtaritë e përfshira në të, me detyrimet dhe përgjegjësitë, me format e vlerësimit dhe provimin final.</p> <p><i>Evidencë R.4 Syllabuset e lëndëve BSc. IE 2021-2022; VKM nr. 41, datë 24.01.2018; VKM nr. 879, datë 18.12.2019.</i></p>			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>GVJ konstaton se stafit akademik i kërkohet të përditësojë syllabuset në fillim të vitit akademik. Programi i studimit, plani mësimor, disiplinat mësimore dhe veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program dhe kreditet për secilën prej tyre rishikohen në mënyrë periodike, si përgjigje ndaj kërkesave të tregut të punës dhe dinamikave të brendshme.</p> <p>Me qëllim reflektimin e kërkesave të tregut të punës, përvojave më të mira nga universitetet homologe europiane, ndryshimet e objektivave dhe strategjive kombëtare, mendimet e pedagogëve dhe opinionet e studentëve programet e studimit duhen përmirësuar e përditësuar vazhdimisht.</p> <p>Gjatë vitit 2019, Departamenti i Inxhinierive ka rishikuar programet e studimit Bachelor. Programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri Elektrike" nuk ka ndryshime në përmbajtje, por u aplikua një rishpërndarje e krediteve dhe përditësim/unifikim i raportit ECTS/orë në auditor në përputhje me aktet ligjore në fuqi.</p> <p><i>Evidencë 2.5 Procedura e rishikimit të kurrikulave – 04.2019; Evidencë R.4 Syllabuset e lendeve BSc. IE 2021-2022; Evidencë 2.6.d, Rishikime syllabuset - v.a. 2021 – 2022; RVB, fq. 12.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimet të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Programi i Bachelor në “Inxhinieri Elektrike” është i organizuar në 3 vite akademike, me 180 kredite në total ose 60 ECTS/vit. Programi ka 30 lëndë, të kategorizuara si lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe përmbyllëse. Siç e kemi përmendur edhe më lart, konstatohet se ky organizim është bërë në përputhje të plotë me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Ndarja e orëve mësimore paraqitet si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Viti I: 628 orë në auditor; 872 orë studimi individual (1500 orë në total); – Viti II: 644 orë në auditor; 856 orë studimi individual (1500 orë në total); – Viti III: 598 orë në auditor; 902 orë studimi individual; 80 orë praktikë profesionale (1500 orë në total). <p>Sa më lart, në total janë 1870 orë në auditor, 2630 orë studimi individual dhe 80 orë praktikë profesionale, duke bërë në total 4500 orë.</p> <p><i>Evidencë 2.1.b Plani mësimor BSc. IE - 04.2019.</i></p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>Emërtimi i programit të ciklit të parë Bachelor në “Inxhinieri Elektrike” është në përputhje me fushën akademike të tij. Përmbajtja e veprimtarive mundëson përgatitjen e studentëve me aftësi teorike dhe praktike. GVJ vlerëson se ky program studimi mundëson përgatitjen e studentëve me aftësi teorike dhe praktike, një element mjaft i rëndësishëm ky për t’u përballur me tregun e punës pas diplomimit të tyre apo thellimit të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme.</p> <p><i>Evidenca 2.1.b Plani mësimor BSc. IEK - 04.2019.</i></p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se mundësohet arritja e objektivave formues të programit të studimit në Bachelor “Inxhinieri Elektrike” dhe rezultateve të pritshme të të nxënit, aftësimin profesional dhe kërkimit shkencor. Në vitin e I zhvillohen kryesisht lëndët bazë, ndërsa në vitin II dhe III zhvillohen lëndët karakterizuese, ndërdisiplinore dhe përmbyllëse. Kjo mundëson që baza teorike e lëndëve të formimit bazë të shërbejë në përvetësimin më të mirë të dijeve prej lëndëve me karakter profesional.</p> <p><i>Evidencë H.1 Rregullore mësimore BSc. IE - 20.03.2019; Evidencë 2.1.b Plani mësimor BSc. IE - 04.2019; Evidencë R.4 Sylabusët e lëndëve BSc. IE 2021-2022; Vizita në Institucion, takimi me stafin e programit.</i></p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit</p>	<p>GVJ konstaton se lëndët janë në përputhje me profilin e programit Bachelor “Inxhinieri Elektrike” dhe rrjedhimisht të domosdoshme për formimin e specialistëve në këtë fushë studimi. Nga vizita në institucion, GVJ konstaton se raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit. Lëndët</p>

<p>bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>janë të organizuara në aktivitete formuese Leksion/Ushtime (seminar). Në secilën prej tyre ka aktivitete formuese teorike dhe praktike.</p> <p><i>Evidencë H.1 Rregullore mësimore BSc. IE - 20.03.2019; Evidencë 2.1.b Plani mësimor BSc. IEK - 04.2019; Evidencë R.4 Syllabuset e lendeve BSc. IE 2021-2022; Vizita në Institucion, takimi me studentët dhe stafin akademik.</i></p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues dhe formimin e specialistëve të aftë në fushën e inxhinierisë elektrike.</p> <p>Njohuritë e marra gjatë studimeve në këtë program studimi i mundësojnë studentit transferimin ose/dhe vazhdimin e studimeve të ciklit të dytë në programe të ngjashme brenda dhe jashtë vendit, si dhe punësimin e tij në përputhje me fushën e studimit në ente publike dhe private kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>Sasia e orëve në auditor (1870 orë) për përgatitjen praktike (Seminare, laboratorë, projekte praktikë, etj) është 1086 orë, nga 784 orë totale për përgatitjen teorike (orët e leksioneve), ose orët në auditor për përgatitjen praktike zënë rreth 58% të orëve totale në auditor. GVJ gjykon që raporti i tyre është në përputhje me ciklin e parë të studimeve.</p> <p><i>Evidencë H.1 Rregullore mësimore BSc. IE - 20.03.2019; Evidencë 2.1.b Plani mësimor BSc. IEK - 04.2019; Evidencë R.4 Syllabuset e lendeve BSc. IE 2021-2022; Evidencë RVB - BSc. IEK - 2022. Tabela 13</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion GVJ konstaton se syllabuset rishikohen në fillim të vitit akademik për të futur literaturat e reja, të cilat duhet të jenë të 5 viteve të fundit. <i>Nga shqyrtimi i syllabuseve, evidentohet se një pjesë e literaturës në syllabuse nuk është e 5 viteve të fundit</i> (psh. Elektroteknikë I, Makinat Elektrike, Prodhimi, shpërndarja, përdorimi i energjisë elektrike etj.). Botimet në gjuhën shqipe të teksteve mësimore nga autorë shqiptarë janë brenda 10 vjeçarit të fundit. Gjithashtu, edhe një pjesë e literaturës në gjuhë të huaj ndodhet brenda këtij intervali botimi.</p> <p>Hapat tepër të shpejtë të zhvillimit të disiplinave inxhinierike duhet të shoqërohen me një literaturë përkatëse bashkëkohore.</p> <p><i>Evidencë R.4 Syllabuset e lëndëve BSc. IE 2021-2022.</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Bazuar në lëndët e programit të studimit dhe syllabuset e lëndëve përkatëse, evidentohet se programi i studimit ka përmbajtje didaktike dhe profesionale formuese dhe garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave që synon programi dhe niveli Bachelor.</p> <p><i>Evidencë 2.1.b Plani mësimor BSc. IE - 04.2019; Evidencë R.4 Syllabuset e lendeve BSc. IE 2021-2022.</i></p>
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Elektrike” u jep mundësi studentëve të pozicionohen në karrierën e tyre të ardhshme profesionale. Nga shqyrtimi dokumentacionit dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se programi i studimit, duke kombinuar teorinë me praktikën, siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional në fushën e Shkencave të Inxhinierisë Elektrike.</p>

	<i>Evidencë 2.1.b Plani mësimor BSc. IE - 04.2019; Evidencë R.4 Sylabuset e lendeve BSc. IE 2021-2022.</i>			
Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Përmbajtja e programit të studimit synon të mundësojë punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmërinë dhe kërkesat e tregut e punës. Në vijimësi, NJSBC dhe Departamenti i Inxhinierive konsultohen me bashkëpunëtorët prej biznesit e tregut të punës në lidhje me trendet e reja të fushës së inxhinierisë elektrike dhe përpiqen të bëjnë përditësimet tek programet e studimit, si psh. me ERE. <i>Evidencë 1.4.b Raport mbi studimin e tregut - DI - Dhjetor 2021. Evidencë R.3 Marreveshje ERE - 18.02.2022.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5	
Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, të dhënat për stafin e angazhuar në mësimdhënie për programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Elektrike” për gjatë katër viteve të fundit akademike paraqiten si në vijim: <ul style="list-style-type: none"> – Viti akademik 2018-2019: 17 PAE, me kualifikimin 9 Dr., dhe 8 Msc.; 11 PAK, me kualifikimin 1 Prof. Dr., 4 Prof. As., 5 Dr., dhe 1 Msc.; – Viti akademik 2019-2020: 15 PAE, me kualifikimin 8 Dr., dhe 7 Msc.; 12 PAK, me kualifikimin 1 Prof. Dr., 4 Prof. As., dhe 7 Dr.; – Viti akademik 2020-2021: 16 PAE, me kualifikimin 9 Dr., dhe 7 Msc.; 11 PAK, me kualifikimin 1 Prof. Dr., 4 Prof. As., dhe 6 Dr.; – Viti akademik 2021-2022: 16 PAE, me kualifikimin 2 Prof. As., 7 Dr., dhe 7 Msc.; 13 PAK, me kualifikimin 1 Prof. Dr., 4 Prof. As., dhe 8 Dr. <i>Evidencë Aneks tabela – RVB.</i>
Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.	Nga verifikimi i të dhënave, u konstatua se për katër vitet e fundit akademike, personeli akademik efektiv ka mbuluar mbi 70% të ngarkesës mësimore të programit të studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Konkretisht, raporti i % së mbulimit të ngarkesës nga personeli akademik efektiv dhe me kontratë (PAE/PAK) paraqitet si në vijim: <ul style="list-style-type: none"> – Viti akademik 2018-2019: 74.9% PAE / 25.1% PAK; – Viti akademik 2019-2020: 71% PAE / 29% PAK; – Viti akademik 2020-2021: 72.9% PAE / 27.1% PAK; – Viti akademik 2021-2022: 70.2% PAE / 29.8% PAK.

	<p>Të dhënat mbi ngarkesën totale të stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi, duke përfshirë edhe ngarkesën në programe të tjera studimi të institucionit për vitin aktual akademik (2021-2022), paraqiten si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Stafi PAE: Ngarkesa në orë (min – max) është 175 - 1003, ndërsa ngarkesa mesatare në orë është 480; • Stafi PAK: Ngarkesa në orë (min – max) është 23 – 331, ndërsa ngarkesa mesatare në orë është 137. <p>Bazuar në Udhëzim nr. 29, dt. 10.09.2018 i Ministrisë përgjegjëse për arsimin, Kreu III, pika 5, IAL nuk ka një kufizim ligjor mbi ngarkesën maksimale të lejuar për stafin akademik në IAL jopublike. Megjithatë, <i>ngarkesa mësimore e personelit akademik efektiv është kryesisht tepër e lartë, rreth 69% e tyre kanë ngarkesë më shumë se 400 orë mësimore, ku maksimumi shkon 1003 orë. Ky fakt nuk i vjen në ndihmë përpjekjeve që AU bën për rritjen e cilësisë në mësimdhënie. Gjithashtu, kategoria “Profesor” ka një ngarkesë vjetore të lartë për këtë kategori.</i></p> <p><i>Nga shqyrtimi i syllabuseve, evidentohet se jo të gjithë titullarët e lëndëve janë të kategorisë “Profesor”. Institucioni dhe DI ka bërë përpjekje për të realizuar përcaktimin e titullarëve të lëndëve sipas përcaktimeve ligjore, por disa prej lëndëve (Makina elektrike 1, Makina elektrike 2, Teknikë sigurimi, Praktika mësimore, Sistemet elektrike të fuqisë, Ndriçimi elektrik) titullari i lëndës ka gradën shkencore “Doktor”. Vihet re se titullarët e shumicës së lëndëve janë me tituj akademik “Prof. As” dhe “Prof” nga personeli akademik PAK.</i></p> <p><i>Evidencë 2.8.d Ngarkesa mësimore stafi akademik BSc IE 2021-2022; Evidencë Aneks tabela – RVB; Evidencë R.4 Syllabuset e lendeve BSc. IEK - v.a 2021 - 2022.</i></p>
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se personeli akademik i programit është i specializuar në fusha specifike të cilat mbulojnë të gjitha lëndët që zhvillohen në këtë program studimi, gjë që garanton formimin e specialistëve të fushës me aftësi të larta.</p> <p><i>Evidencë 2.9 CV stafi akademik dhe personeli ndihmës akademik (laborant) BSc. IE - 2021 – 2022.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>AU ka një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e institucione të sektorit publik. Departamenti i Inxhinierive vë në dispozicion personel të mjaftueshëm e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale. Çdo pedagog ka nën mbikëqyrje jo më shumë se 20 studentë.</p> <p>Diploma <i>Bachelor</i> mbrohet me provim formimi ose punim (tezë) diplome. Përgjegjësi i Departamentit u bën të njohur studentëve të cilët diplomohen, programin e provimit të formimit ose të temave të diplomave. Studentët që kanë mesatare mbi 8 fitojnë të drejtën e zhvillimit të një punimi diplome. Numri i studentëve që kanë mbrojtur temë diplome mbetet i ulët në krahasim me atë që kalon në provim formimi.</p>


	<i>Evidencë Aneks tabela - RVB; Evidencë 3.9.a Procedurë Diploma Bachelor – v.a. 2021 – 2022; Evidencë 3.9.b Shembull Procedurë Diplome BSc. IE - v.a. 2020 – 2021. Evidenca 2.10 Miratim udhëheqës praktika mësimore Bachelor - v.a. 2020 - 2021</i>			
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	<p>Gjatë vizitës në ambientet e shkollës (klasat /laboratorët ku bëhet mësim nga studentët e këtij programi) u konstatua se mirëmbajtja e laboratorëve kryhej prej stafi mbështetës. Nga intervistat me stafin akademik dhe studentët GVJ konstatoi se pedagogët e lëndës realizojnë dhe anën praktike të saj (laboratorët).</p> <p>Në Departamentin e Inxhinierive, në katër vitet e fundit akademike është angazhuar personel ndihmës akademik (laborant) si në vijm: në vitin akademik 18-19 janë angazhuar 2 laborantë; në vitin akademik 19-20 është angazhuar 1 laborant; në vitin akademik 20-21 janë angazhuar 2 laborantë dhe në vitin akademik 21-22 janë angazhuar 2 laborantë.</p> <p>Nga shqyrtimi i CV-ve stafi akademik është i përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike.</p> <p><i>Evidencë 2.9 CV stafi akademik dhe personeli ndihmës akademik (laborant) BSc. IE 2021 – 2022; Evidencë Aneks tabela – RVB; Vizita në Institucion, takimi me stafin akademik dhe studentët e programit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.	AU në nivel institucional ka hartuar udhëzuesin për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve e moduleve. Personeli akademik përdor platformën Microsoft Teams, të mundësuar nga Institucioni, për të vënë në dispozicion të studentëve materialet mësimore. Karakteri inxhinierik i programit të studimit sugjeron ndërthurjen e trajtimit teorik me zbatimin praktik përmes përdorimit të softveve inxhinierike dhe laboratorëve. Në mbështetje të kësaj objektive, AU ka vënë në dispozicion laboratorë me kompjuterë.

	<p><i>Evidencë H.1 Rregullore mësimore BSc. IE - 20.03.2019; Evidencë 3.1 Klasat Microsoft Teams - Departamenti i Inxhinierive; Evidencë 3.2.c Udhëzues video për përdorimin e platformës Microsoft Teams.</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konstaton se një nga objektivat strategjik të AU është cilësia dhe performanca akademike. Strukturat përgjegjëse kanë zhvilluar mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik. NJSBC që funksionon në nivel IAL, ka si detyrë ndjekjen në vazhdimësi të treguesve të cilësisë, të cilët i vlerëson mbi bazë të një pyetësori me shumë rubrika dhe mbi rezultatet e të cilit formulon një raport ku evidentohen problemet që shohin studentët në procesin e realizimit të programit të studimit.</p> <p><i>Evidencë 6.7.a - d Fokus Grupe 2019 – 2022; Evidencë 6.8.a - e Rezultatet e pyetësorit drejtuar personelit akademik për mësimin online v.a. 2019 – 2021.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni përfshin studentët në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies duke ju dhënë mundësi atyre të plotësojnë pyetësorë përpara përfundimit të çdo semestri. Studenti i këtij programi studimi anketohet lidhur me: standardet dhe cilësinë e mësimdhënies, shkeljen e procedurave/rregullores ndaj tij, nga personeli akademik ose ai administrativ, vlerësimin në formate të ndryshme të kontrollit të dijeve, vlerësimin përfundimtar të lëndës, etj. NJSBC ka hartuar raport të detajuar në lidhje me rezultatet e pyetësorëve dhe shprehet se kur ka pasur ankesa ato janë trajtuar.</p> <p><i>Evidencë 6.8.a - e Rezultatet e pyetësorit drejtuar personelit akademik për mësimin online v.a. 2019 – 2021; Evidencë 4.2 Rregullore e sekretarisë mësimore.</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Njësisia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë është struktura përgjegjëse për vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarive mësimore në AU. Monitorimi dhe vlerësimi i performancës së personelit akademik dhe ndihmës akademik realizohet nga Përgjegjësi i Departamentit. Ai vlerëson performancën e personelit akademik me anë të formularit të vlerësimit. NJSBC analizon, mbi bazën e metodave statistikore, vlerësimet e cilësisë së mësimdhënies dhe gjeneron një raport individual për secilin anëtar të stafit akademik. Raporti komunikohet tek autoritetet drejtuese të “Albanian University”. Ky raport i shkon gjithashtu përgjegjësit të njësisë bazë, i cili vë në dijeni të vlerësimit të bërë nga studentët në mënyrë konfidenciale personelin akademik.</p> <p><i>Evidencë 1.2 Statuti Albanian University; Evidencë 6.8.d Rezultatet e pyetësorit drejtuar studentëve për mësimin online v.a. 2020 - 2021 - Sem. I.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Rezultatet e vlerësimit të cilësisë përpunohen dhe përmbledhen në një raport. Këto rezultate raportohen me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. NJSBC përgatit raportin e vlerësimeve periodike dhe i vë në dispozicion të strukturave drejtuese, pedagogëve dhe palëve të tjera të interesuara. Gjithashtu, AU nxit shembuj të praktikave më të mira, inkurajon dhe motivon stafin akademik për të përmirësuar më tej mësimdhënien duke</p>

	<p>organizuar aktivitete të ndryshme trajnimi, leksione të hapura dhe seminare me profesorë të ftuar.</p> <p>Departamenti i Inxhinierive është i përfshirë në projekte të ndryshme ndërkombëtare që AU ka me universitete ndërkombëtare, përmes të cilave motivon stafin të marrë pjesë në programet e mobilitetit si Erasmus+, KAI ose KA2, për të përmirësuar aftësitë e tyre mësimdhënëse.</p> <p><i>Evidencë 6.8.d Rezultatet e pyetësorit drejtuar studentëve për mësimin online v.a. 2020 - 2021 - Sem. I.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi III.2	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se personeli akademik i programit zhvillon format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive përmes leksioneve, seminareve, punëve laboratorike, detyrave të kursit, praktikave profesionale, vizita studimore, psh. në stacionet e gjenerimit të energjisë HEC të KESH sha. Syllabuset e lëndëve miratohen në departament.</p> <p><i>Evidencë H.1 Rregullore mësimore BSc. IEK - 20.03.2019; Evidencë R.4 Syllabuset e lëndëve BSc. IE 2021 – 2022; Evidenca 3.5.a Informacion mbi programin e vizitës në HEC Fierzë - 06.04.2019.</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Personeli akademik i programit të studimit Bachelor "Inxhinieri Elektrike" merr pjesë në trajnimet e orientuara në aspektet didaktike të mësimdhënies të organizuara nga AU. Gjithashtu gjatë punës me studentët ata nxiten të përdorin metoda inovative të mësimdhënies. Personeli akademik merr në konsideratë nevojat e studentëve dhe bashkëpunon me ta për të ofruar një eksperiencë mësimdhënie-mësimnxënie sa më të mirë.</p> <p><i>Vizita në Institucion, takimi me stafin e programit.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>GVJ konstaton se "Albanian University" ofron kushte dhe infrastrukturë të mirë për procesin e mësimdhënies, mbështet dhe stimulon personelin akademik për të përmirësuar kompetencat didaktike si dhe përditësimet e metodave të mësimdhënies, në përputhje edhe me objektivat dhe misionin e institucionit. Në funksion të programit të studimit janë laboratorët e DI, broshurat informuese, guida për studentët. Një avantazh tjetër është edhe biblioteka e AU ku të gjitha materialet mësimore gjenden në formën klasike: libra fizikë, literaturë elektronike, si dhe materiale të lëndës të ofruara nga pedagogu nëpërmjet platformës Microsoft Teams.</p> <p>GVJ gjatë vizitës në institucion konstaton se mjediset ku zhvillohet mësimi i programit të studimit Ciklit të Parë Bachelor "Inxhinieri Elektrike"</p>

	mundësojnë për personelin akademik përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe të ndryshme pedagogjike.			
	<i>Vizita në Institucion, takimi me Përgjegjësën e Departamentit.</i>			
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.	GVJ pas analizimit të CV-ve të personelit akademik konstaton se personeli akademik i programit të studimit Bachelor “Inxhinieri Elektrike” zotëron përgatitje dhe kompetenca profesionale në mësimdhënie dhe në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve. Nga anketimi i studentëve lidhur me procesin mësimor gjatë semestrit të parë të vitit akademik 2020-2021 ku morën pjesë 26 % e studentëve të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, 80% e pjesëmarrësve pohojnë se pedagogët aplikojnë metoda dhe mjete mësimdhënieje në ndihmë të studentëve, 12% shprehen neutral dhe vetëm 8% nuk janë dakord me këtë pohim.			
	<i>Evidencë 6.8.d Rezultatet e pyetësorit drejtuar studentëve për mësimin online v.a. 2020 - 2021 - Sem. I; Evidencë 2.9 CV stafi akademik dhe personeli ndihmës akademik (laborant) BSc. IE - v.a. 2021 – 2022.</i>			
Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	GVJ konstaton se format e metodat e mësimdhënies vlerësohen nga eprori dhe studentët, kjo nëpërmjet komunikimit direkt me pedagogun apo përgjegjësën e njësisë bazë, mendime që shprehen nga përfaqësuesi i studentëve në mbledhje të njësisë bazë etj. Pyetësorët e hartuar në mënyrë periodike janë një mënyrë tjetër vlerësimi për metodat e mësimdhënies.			
	<i>Evidencë 6.8.d Rezultatet e pyetësorit drejtuar studentëve për mësimin online v.a. 2020 - 2021 - Sem. I; Vizita në Institucion, takimi me stafin e programit.</i>			
Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimin.	Nga shqyrtimi dokumentacionit, si manuali për realizimin e mësimin online 2020-2021 dhe vizita në institucion. takimi me studentët dhe stafin akademik, GVJ konstaton se personeli akademik përdor metoda bashkëveprimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimin. Këto metoda përfshijnë simulime, video, detyrë kursi, diskutime, prezantime, etj.			
	<i>Evidenca 3.2.a Manual per realizimin e mesimit online 2020 – 2021; Vizita në Institucion, takimi me studentët dhe stafin akademik të programit.</i>			
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënies të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Personeli akademik është inkurajuar nga “Albanian University” të zbatojë mësimdhënien me në qendër studentin, e cila krijon mundësi që studentët të ndërtojnë vetë dijet duke ndërvepruar dhe punuar në mënyrë të pavarur, ndërsa pedagogët e programit të shndërrohen në mbështetës të procesit mësimor.			
	<i>Vizita në Institucion, takimi me stafin akademik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitave të hapësirave vlerëson se procesi mësimor e shkencor i programit të studimit Bachelor “Inxhinieri Elektrike” realizohet në hapësira të mjaftueshme, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p> <p>Sipas tabelës përmbledhëse ofruar nga “Albanian University”, godinat ku zhvillohet mësimi për Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike ka sipërfaqe totale 1780 m² dhe ka një numër total prej 552 studentësh që zhvillojnë mësimin në këtë godinë, për të gjitha programet e studimit që mbulohen nga Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike. Si rrjedhim, koeficienti i përdorimit të ambienteve prej studentëve të tij është $1799.37 \text{ m}^2 / 552 \text{ studentë} = 3.26 \text{ m}^2/\text{student}$ dhe 4.58 m^2 për personelin.</p> <p>Mbështetur në Vendim Nr. 418, datë 10.05.2017 “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre”, në Aneks 1, pika C: Normativa e sipërfaqes së shfrytëzueshme, për objektet që do të ofrohen nga IAL me programe studimi “Inxhinieri dhe teknologji” është 5m² për student. Pra, vihet re se ambientet që AU ofron janë të pamjaftueshme.</p> <p><i>Evidencë 3.7 Planimetritë - Godina e Rr. Kavajës – 2020; RVB Tabela Aneksë; Vizita në Institucion.</i></p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës së ambienteve të dedikuara për procesin mësimor, konstaton se klasat dhe laboratorët mësimorë janë të pajisur me kompjuterë dhe projektorë.</p> <p>Mjediset e klasave, auditorëve, laboratorëve etj, ku zhvillohet mësimi, janë të pajisura me kompjuterë, video projektorë dhe internet. Përgjithësisht mësimi zhvillohet i kombinuar: sipas mënyrës tradicionale dhe metodave që përdorin teknologjinë bashkëkohore për rritjen e efektivitetit të mësimdhënies e mësimnxënies.</p> <p>Ambientet e bibliotekës kanë kapacitet të mjaftueshëm. Biblioteka ka kushte të mira dhe është e pajisur me kompjuterë, si dhe funksionon me orar të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për studentët.</p> <p><i>Evidencë 3.8 Lista e librave në bibliotekë – 2021; Vizita në ambientet e Institucionit.</i></p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>AU ka në shfrytëzim platformën elektronike në Departamentin e Inxhinierive, përdorimin e platformës Microsoft Teams, pjesë e paketës Office 365, të mundësuar nga Institucioni, për të vënë në dispozicion të studentëve materialet mësimore. Platforma “Microsoft Teams” ofron disa shërbime si: e-learning (marrje materialesh prej pedagogëve), zhvillim mësimi online, dorëzime detyrash, komunikim interaktiv student-pedagog përmes hapësirës së dedikuar që ka seicili student në këtë platformë.</p>



	<i>Evidencë 3.2.c Udhëzues video për përdorimin e platformës Microsoft Teams; Vizita në Institucion, takimi me Përgjegjësin e Departamentit.</i>
Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.	Literatura bazë dhe e rekomanduar mbi të cilat organizohet dhe mbështetet procesi mësimor në “Albanian University” garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme në fushën inxhinierisë elektrike, edhe pse duhet një përditësim më i mirë i saj. Të gjithë lektorët mund të propozojnë titujt që mund të shtohen në bibliotekë. Biblioteka e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike ka kryesisht tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse. Në bibliotekë ka gjithsej rreth 120 tituj, në gjuhën shqipe (67 tituj) dhe të huaj, anglisht (53 tituj), ku kryesisht literatura në gjuhën shqipe është tekst mësimor, <i>por ato konsiderohen të pamjaftueshme për studentët e programit Bachelor në “Inxhinieri Elektrike”. Fondi i saj nevojitet të pasurohet me tituj të rinj dhe revista teknike bashkëkohore, me qëllim mbështetjen e studentëve në punën kërkimore për detyrat e kursit në lëndët e formimit profesional dhe diplomat.</i>
Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	<i>Evidenca R.4, Syllabuset e lendeve BSc. IEK - v.a 2021 – 2022; Vizita në bibliotekën e Institucionit.</i>
Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	Sipas RVB, personeli akademik dhe studentët e programit Bachelor “Inxhinieri Elektrike” aksesojnë librarinë online në të cilën gjenden të listuara libra dhe artikuj që lidhen me lëndët e trajtuara në këtë program studimi si libraritë online EBSCO, Getty ERIC – Education Resources Information Center Cambridge Journals dhe 11 librari për departamentin e inxhinierive. <i>Vizita në bibliotekën e Institucionit; RVB, Tabela 17 Aneksë.</i>
Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	Departamenti i Inxhinierive ka në dispozicion të studentëve 9 laboratorë me disa module, ku zhvillohen seancat laboratorike. Nga takimi me Përgjegjësin e Departamentit u konfirmua se “Albanian University” dhe Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike vazhdon të ketë në vëmendje mundësinë e ngritjes së laboratorëve të reja për lëndë të karakterit profesional, duke e konsideruar këtë aspekt si një ndër pikat e forta të saj. <i>Vizita në Institucion, takimi me përgjegjësin e departamentit dhe ambientet.</i>
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik dhe studentët përdorin platformën Microsoft Teams, pjesë e paketës Office 365. Kjo platformë është konfiguruar dhe përshtatur në vitin akademik. <i>Evidenca 3.2.c Udhëzues video për përdorimin e platformës Microsoft Teams; Vizita në Institucion, takimi me stafin akademik dhe studentët e programit.</i>
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.	“Albanian University” ka vënë në dispozicion llogari në përdorimin e platformës Microsoft Teams, pjesë e paketës Office 365 dhe i ofron studentëve dhe personelit akademik hapësirë vetjake të dedikuar në të cilën mund të ruhet dokumentacioni elektronik si dhe mundësinë e komunikimit elektronik nëpërmjet postës elektronike, që mundëson e-learning dhe komunikim interaktiv të studentëve e pedagogëve, për shkëmbim materialesh mësimore në format pdf, si dhe dorëzimin e detyrave të studentëve.

	<i>Evidenca 3.2.c Udhezues video per perdorimin e platformes Microsoft Teams; Vizita në Institucion, takimi me stafin e programit.</i>			
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Stafi akademik në programin e studimit Bachelor “Inxhinieri Elektrike” mbështet studentët në përzgjedhjen e temave dhe hartimin e tyre. Bazuar në fushën e ekspertizës së pedagogëve të programit studentët zgjedhin udhëheqësin. Në bashkëpunim me udhëheqësin zgjedhin temën me të cilën do të punojnë. <i>Evidencë Nr. H.1 Rregullore mësimore BSc. IEK - 20.03.2019.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.4 Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	“Albanian University” në statutin e tij ka të parashikuar Njësinë e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë si njësi përgjegjëse për vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarive mësimore. NJBSC bashkëpunon për çdo vlerësim të brendshëm të cilësisë që organizon. Rezultatet e Raporteve të vlerësimit të NJBSC shërbejnë si bazë për të hartuar dhe zbatuar programe të zhvillimit pedagogjik dhe didaktik të personelit akademik, proces në të cilin përfshihet edhe Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave sipas kërkesave. <i>Evidencë 1.2 Statuti Albanian University Evidencë 6.4 Strategjia për Sigurimin e Cilësisë 2022 - 2025. Evidencë 6.10 Rregullore NJSBC.</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	Departamenti realizon analiza periodike mbi bazën e të cilave shqyrton situatën e përmbushjes së standardeve të cilësisë së mësimdhënies, duke lënë detyra për zgjidhjen e problematikave të mundshme. Vetëvlerësimi i cilësisë së programit të studimit bëhet duke marrë edhe mendimin e studentëve, kryesisht përmes pyetësorëve që AU organizon 2 herë në vit në lidhje me procesin mësimor dhe aspekte të tjera të jetës studentore në këtë institucion. <i>Evidencë 6.8.a - e Rezultatet e pyetësorit drejtuar studentëve për mësimin online v.a. 2019 – 2021.</i>
Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	“Albanian University” ka një vizion strategjik për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. Nga biseda me stafin akademik dhe studentët u konfirmua se përgjithësisht mësimdhënia tradicionale kombinohet me veprimtari ushtrimore si aplikimi përmes softwareve i koncepteve teorike. Infrastruktura e përshtatshme e mundësuar prej AU e bën këtë gjë të arritshme. <i>Evidencë 1.5.a Plani strategjik institucional 2017 – 2022; Vizita në Institucion, takimi me studentët dhe stafin e programit.</i>
Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë	GVJ konstaton se “Albanian University” mbështet kualifikimin në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor.

<p>të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Në bazë të informacionit të ofruar konstatohet se personeli akademik dhe ai mbështetës për programin e studimit kualifikohet vazhdimisht në mënyrë individuale dhe institucionale (projekte, seminare, trajnime, ëorkshope, konferenca shkencore, etj), ndërsa në fund të vitit paraqitet një raport i realizimit të planit të veprimtarisë kërkimore. Mbi bazën e analizave vjetore, Departamenti i Inxhinierive në AU vlereson punën e personelit akademik, si dhe të departamentit në tërësi dhe nxjerr rekomandimet përkatëse për orientimin më të mirë të kërkimit shkencor.</p> <p><i>Evidencë 2.9 CV stafi akademik dhe personeli ndihmës akademik (laborant) BSc. IEK - v.a. 2021 – 2022; Evidencë 1.1.a - d Raporti Vjetor - DI - v.a. 2018 – 2022; Evidencë 3.6.b Axhenda e trajnimeve te stafit akademik - v.a. 2021 – 2022.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Në udhëzuesin strategjik për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies, AU në kuadër të zhvillimit dhe kualifikimit të mëtejshëm të stafit akademik ka planifikuar fushat e zhvillimit profesional të stafit akademik nëpërmjet trajnimeve, round table me personel shqiptar si edhe online me bashkëpunëtor të huaj.</p> <p><i>Evidencë 3.6.a - b Axhenda e trajnimeve te stafit akademik - v.a. 2019 – 2022.</i></p>			
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Personeli akademik angazhohet për përmirësimin e mësimdhënies duke marrë pjesë në trajnime të organizuar nga institucioni dhe marrë në konsideratë rekomandimet e studentëve. Evidentohet fakti që personeli akademik dhe ndihmës akademik është i interesuar dhe i angazhuar për implementimin sa më të suksesshëm të programit të studimit dhe për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja, duke respektuar detyrimet e akteve rregullatore të departamentit.</p> <p><i>Evidencë 1.1.c Raporti vjetor - DI - v.a. 2020 – 2021; Vizita në Institucion, takimi me stafin e programit.</i></p>			
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe takimit me personelin akademik konstaton se personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, veçanërisht në platformën office 365, rezultatet e të cilave raportohen në relacionet e përgatitura nga pedagogët në përfundim të vitit mësimor dhe pasqyrohen në analizën vjetore të veprimtarisë së Departamentit të Inxhinierive.</p> <p><i>Evidencë 1.1.c Raporti vjetor - DI - v.a. 2020 – 2021; Vizita në Institucion, takimi me stafin e programit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi III.5

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
------------------------	--------------------------------------

<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara në rregulloren e programit.</p> <p>Mënyrat e testimit e vlerësimit të njohurive janë pjesë edhe e syllabuseve të cilat së bashku me rregulloren u bëhen të njohura studentëve javën e parë të çdo semestri akademik. Nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të elementëve të mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Provimi përfundimtar 60 pikë (60%); • Provimi i ndërmjetëm 20 pikë (20%); • Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive në seminare, punë laboratorike, detyra/projekte kursi 20 pikë (20%). <p><i>Evidencë H.1 Rregullore mësimore BSc. IEK - 20.03.2019; Evidencë R.4 Syllabuset e lëndëve BSc. IE - v.a 2021 – 2022; Evidencë 3.2.b Manuali i provimeve online 2020 – 2021.</i></p>			
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Nga takimi me studentët, GVJ konstaton se personeli akademik, në fillim të çdo lënde informon studentët për metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore dhe atë të programit. Rregullat e provimeve, pikavarazhi për testimet gjatë vitit, për detyrat, projektet, aktivizimin në seminare dhe formate të tjera vlerësimi janë të përcaktuara në syllabuset e lëndëve, që njihen nga studentët.</p> <p><i>Evidenca R.4 Syllabuset e lendeve BSc. IEK - v.a 2021 – 2022; Vizita në Institucion, takimi me studentët e programit.</i></p>			
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Testimi e vlerësimi i njohurive realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme. Format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të dijeve gjatë zhvillimit të kursit teorik dhe praktik të një lënde janë: Provimi i ndërmjetëm, Niveli i pjesëmarrjes në seminare, Detyra e kursit (projekte), Provimi përfundimtar. Para provimit pedagogu informon studentët nëse kanë të drejtë të futen në provim, sa pikë kanë fituar gjatë kontrolleve gjatë vitit dhe me cilat kriteret do të vlerësohen përfundimisht.</p> <p><i>Evidencë 1.7 Rregullore FSHAE - 03.07.2018; Evidencë R.4 Syllabuset e lëndëve BSc. IE - v.a 2021 – 2022; Evidencë H.1 Rregullore mësimore BSc. IE - 20.03.2019.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>


<p>Standardi III.6 Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.</p>	<p>GVJ ka shqyrtuar rregulloren e programit të studimit Ciklit të Parë Bachelor “Inxhinieri Elektrike” dhe ka konstatuar se në rregulloren e tij është përcaktuar se si realizohet testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale. Evidentohet fakti që raportet ndërmjet testimit e vlerësimit të vazhduar dhe vlerësimit përfundimtar përcaktohen nga pedagogët në programin e lëndës dhe rriatohen nga Drejtuesi i Departamentit. Format kryesore të kontrollit të vazhduar janë</p>

	<p>detyrat/projektet e kursit, kolokiumet, aktivizirni ne seminare dhe relacionet e punëve laboratorike dhe ato shërbejnë, ashtu si dhe provimi, për vlerësimin përfundimtar me notë.</p> <p><i>Evidencë Nr. H.1 Rregullore mësimore BSc. IE - 20.03.2019; Evidencë R.4 Syllabuset e lendeve BSc. IEk - v.a 2021 - 2022; Evidenca RVB - BSc. IEk - 2022. Tabela 15 Format e kontrollit të njohurive.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Testimi dhe vlerësimi në “Albanian University” është realizuar kryesisht duke kombinuar metodat tradicionale me mjetet elektronike. Në platformën Office 365 personeli akademik i ketij programi studimi ka përdorur formën “assignment” për detyrat dhe projektet e ndryshme të studentëve, duke eliminuar format e ndryshme të abuzimit dhe duke rritur transparencën. Sistemet elektronike të testimit dhe vlerësimit janë mirëpritur nga studentët.</p> <p><i>Vizita në Institucion, takimi me studentët e programit dhe personelin akademik.</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit GVJ konstaton se “Albanian University” ka përcaktuar në rregullore modalitetet për miratimin e komisioneve të provimeve dhe të mbrojtjes së diplomave. Përgjegjësi i Departamentit miraton modalitete të vlerësimit dhe ngre komisionet e provimeve të cikleve përkatëse të studimeve në lëndët që mbulon departamenti. Sipas RVB komisionet e provimeve kanë së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës. Tezat e provimit hartohen nga lektori i lëndës, së bashku me asistentin e tij, dhe miratohen e nënshkruhen nga drejtuesi i departamentit. Një kopje e tezës së provimit depozitohet në departament.</p> <p><i>Evidencë Nr. H.1 Rregullore mësimore BSc. IE - 20.03.2019.</i></p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Në format e kontrollit të njohurive dhe dijeve me shkrim përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, i deklaruar në fletën e provimit dhe i kthyer në notë. GVJ konstaton se provimet me shkrim sekretohen nga personeli i Sekretarisë Mësimore. Departamenti i Inxhinierive merr masa që procesi i testimit të kryhet konform rregullores, duke siguruar ambientet dhe personelin monitorues. Pedagogët e lëndës mbajnë përgjegjësi për vlerësimin e studentëve dhe vendosjen e rezultateve në afatin e përcaktuar. Korrigjimi kryhet në anonimitet duke mundësuar barazi midis studentëve dhe vlerësimin sipas meritës, e cila u konfirmua edhe nga studentët.</p> <p><i>Evidencë 4.2 Rregullore e sekretarisë mësimore; Evidencë Nr. H.1 Rregullore mësimore BSc. IE - 20.03.2019; Vizita në Institucion, takimi me studentët e programit.</i></p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Vlerësimi i komponentëve të vlerësimit shoqërohet me komente nga pedagogu, si dhe një seancë sqaruese zhvillohet pas testit. Në të qartësohen të gjitha kriteret e përdorura në vlerësim dhe studentët ballafaqohen me vlerësimin dhe cilësinë e punimeve të tyre. Edhe në takimin me studentët u konfirmua se procedura e kontrollit të dijeve dhe dhënia e rezultateve bëhet kryesisht sipas rregullores së Departamentit të Inxhinierive dhe nga ana e studentëve nuk u evidentuan problematika që mund ta dëmtonin procesin.</p>

	<i>Evidencë 2.2 Rregullore Departamenti - VS. 20 - 30.07.2021; Vizita në Institucion, takimi me studentët e programit.</i>			
Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.	Studentët që në fillim të procesit mësimor informohen për veprime të ndaluara si kopjimi e plagjiatura. Studenti i cili kryen veprime të ndaluara, përjashtohet nga provimi. Testet e ndërmjetme dhe ai final administrohen nga prania në auditor e dy pedagogëve, të cilët janë përgjegjës për moslejimin e kopjimit. <i>Evidencë R.4 Syllabuset e lendeve BSc. IEk - v.a 2021 – 2022; Evidencë 4.2 Rregullore e sekretarisë mësimore.</i>			
Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Dorëzimi i vlerësimeve të provimeve bëhet jo më vonë se 7 ditë nga data e zhvillimit të tyre. Rezultatet e kontrollit të dijeve merren pasi korrigjohen provimet me shkrim dhe merret parasysh edhe ecuria e studentit gjatë semestrit, sipas pikëve të përcaktuar në syllabuset (frekuentimi, pjesëmarrja në diskutime, performanca në kryerjen e detyrave etj.) <i>Evidencë Nr. H.1 Rregullore mësimore BSc. IE - 20.03.2019.</i>			
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Në rregulloren e Universitetit përcaktohet e drejta e studentit për ankimimin e rezultateve të provimit. Çdo student ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi ose të kundërshtojë rezultatin e marrë në provim. Komisioni i vlerësimit sqaron vlerësimin e bërë dhe në rast mos-dakordësie studentit i lind e drejta e ankimimit duke e depozituar me shkrim pranë sekretarisë mësimore të programit të studimit përkatës, brenda 48 orëve nga shpallja e rezultateve. <i>Evidencë Nr. H.1 Rregullore mësimore BSc. IE - 20.03.2019.</i>			
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	GVJ konstaton se në rregullore përcaktohet se ankimimi i studentit i dërgohet Dekanit përkatës dhe ai ngre një komision ad-hoc i cili bën verifikimin e pretendimeve të studentit dhe pas vlerësimit të ankimit merr vendimin përkatës. Vendimi lidhur me rivlerësimin e provimit merret brenda një jave nga dita e depozitimit të ankesës dhe i bëhet i njohur studentit nëpërmjet sekretarisë mësimore. <i>DVV Evidencë Nr. H.1 Rregullore mësimore BSc. IE - 20.03.2019.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.7	
Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Mbështetur në rregulloren e programit të studimit Bachelor “Inxhinieri Elektrike”, GVJ konstaton se synohet formimi i ekspertëve dhe specialistëve në nivel cilësor në fushën e inxhinierisë elektrike. Bazuar në syllabuset e lëndëve të veçanta, ky program zhvillon dijet e studentëve dhe avancimin e tyre teknik e profesional në fushën e inxhinierisë elektrike. Veprimtaritë formuese zhvillohen prej 30 lëndëve, grupohen në 5 kategori: lëndë bazë 18.33%, lëndë karakterizuese 52.22%, ndërdisiplinore 13.89%, plotësuese

	<p>12,22% dhe përmbyllëse 3.33%. Pra, zhvillimi i programit të studimit bëhet sipas VKM nr. 41, dt. 24.01.2018, e ndryshuar dhe mundëson marrjen e njohurive në mënyrë të balancuar dhe që lejon aftësimin profesional të studentit.</p> <p><i>Evidencë H.1 Rregullore mësimore BSc. IE - 20.03.2019; Evidencë 2.1.b Plani mësimor BSc. IE - 04.2019; Evidencë R.4 Syllabuset e lëndëve BSc. IE - v.a 2021 – 2022.</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Programi i studimit Bachelor “Inxhinieri Elektrike” zhvillon aftësi të veçanta në fushën e inxhinierisë elektrike përmes lëndëve karakterizuese sipas drejtimeve që ka programi i studimit. Në programin lëndor ka dhe lëndë me zgjedhje të karakterit profesional si ndriçimi elektrik dhe sistemet elektrike të fuqisë që përforcojnë këtë qëllim. Programi i studimit siguron zhvillimin e aftësive bazike në fushat e teknologjisë së informacionit, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit, sepse në kurrikulën e tij janë përfshirë lëndë të tilla si Elemente bazë të informatikës, Teknikat dhe gjuhët e programimit, Gjuhë e huaj, Ekonomia e ndërmarrjeve elektrike, Praktikë profesionale. Programi synon gjithashtu zhvillimin e aftësive të respektimit të parimeve etike dhe humane të zbatimit të inxhinierisë elektrike. Syllabuset e programit të studimit garantojnë përveç zhvillimit të aftësive e kompetencave në fushën elektrike, edhe aftësimin në fushat e menaxhimit, ekonomike, të komunikimit dhe gjuhës së huaj.</p> <p><i>Evidencë H.1 Rregullore mësimore BSc. IE - 20.03.2019; Evidencë 2.1.b Plani mesimor BSc. IE - 04.2019; Evidencë R.4 Syllabuset e lëndëve BSc. IE - v.a 2021 – 2022.</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Në përfundim të vitit akademik pedagogët titullarë të lëndëve analizojnë kompetencat dhe aftësitë e përfituara nga studenti. Staf i akademik harton raportin semestral, në të cilin raporton për realizimin e objektivave të mësimdhënies. Departamenti i Inxhinierive analizon kompetencat profesionale të fituara nga studentët dhe i paraqet ato në analizën vjetore të tij, mbi arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional në programin e studimit Bachelor “Inxhinieri Elektrike”.</p> <p><i>Evidenca 3.4.a Shembull raporti semestral PAE; Evidencë 3.4.b Shembull raporti semestral PAK; Evidencë 1.1.a-d Raporti vjetor - DI - v.a. 2018 – 2022.</i></p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Sipas RVB dhe informacionit të marrë gjatë vizitës, përpara testit ndërmjetës dhe përpara testit final pedagogët bëjnë një përmbledhje të njohurive kryesore të trajtuara dhe orientojnë studentët mbi strukturën e testit ndërmjetës dhe atij final. Pedagogët përfshijnë në diskutim edhe studentët dhe marrin mendimin e tyre për çfarë mund të përmirësohet në vijim.</p> <p><i>Vizita në Institucion, takimi me studentët e programit dhe personelin akademik.</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës</p>	<p>Personeli akademik i programit të studimit Bachelor “Inxhinieri Elektrike” është angazhuar edhe në veprimtari të tjera si konferenca apo seminare të ndryshme, ku kanë prezantuar edhe teknologji të ndryshme në auditore të</p>



<p>dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>zgjehuara ku marrin pjesë jo vetëm studentët e programit të studimit por edhe studentë dhe pedagogë nga programe të ndryshme studimi të fakulteteve të tjera, si Leksioni i hapur “Projektet europiane: Nga ideja tek implementimi” nga Prof. Asoc. V.S, nga Universiteti i Salernos, 2020; Leksion i hapur “Disenjimi dhe konstruktimi i dorës robotike të komanduar për lëvizje të ndryshme”, Prof. A.P, nga Universiteti i Prishtinës, 2021; Leksion i hapur “Roli i e-learning: Situata aktuale dhe ide për të ardhmen”, Dr. L.P, 2021, etj.</p> <p><i>Evidencë 1.1.a- d Raporti vjetor - DI - v.a. 2018 – 2022; Evidenca 3.4.a Shembull raporti semestral PAE; Evidencë 3.4.b, Shembull raporti semestral PAK; Vizita në Institucion, takimi me personelin akademik të programit.</i></p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>GVJ vlerëson se personeli akademik transmeton dijet e tyre tek studentët duke demonstruar njohuritë dhe duke kryer ekspertiza laboratorike. Gjate zhvillimit të orëve mësimore, studentët realizojnë prezantime apo detyra kursi dhe projekte të ndryshme në fushën e inxhinierisë elektrike.</p> <p><i>Vizita në Institucion, takimi me personelin akademik të programit.</i></p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Sipas RVB dhe në bazë të vizitës së GVJ në institucion, personeli akademik në mënyrë të vazhdueshme mbështet, orienton dhe instrukturon studentët në realizimin e detyrave të caktuara, pjesë e programeve mësimore të lëndëve të ndryshme. Detyra e kursit në lëndët përkatëse është një mundësi reale për zhvillimin e punës në grup. Personeli akademik i programit të studimit mbështet punën në grup duke marrë pjesë në organizimin e seminareve dhe ëorkshope-ve për të rritur kompetencat e studentëve në fusha dhe teknologji të reja në fushën e studimit.</p> <p><i>Evidencë 2.12.c Axhenda - Konferenca - IIST – 2019- 2021; Vizita në Institucion, takimi me personelin akademik të programit.</i></p>
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p>	<p>Përgjithësisht, temat e detyrave të kursit janë raste studimi reale, në të cilat personeli akademik nxit studentët që ta trajtojnë studimin dhe ofrimin e zgjidhjes së problemeve duke u organizuar në skuadër.</p> <p>Detyrat e kursit, pjesë e programeve mësimore të çdo lënde, mbështesin e zhvillojnë ide inovative.</p> <p>Stafi akademik i Departamentit të Inxhinierive mbështet implementimin e ideve inovative të studentëve, gjatë detyrave të kursit, diplomave, si dhe nxit pjesëmarrjen e tyre në konferencën studentore.</p> <p><i>Evidencë 2.12.c Axhenda - Konferenca - IIST – 2019- 2021.</i></p>
<p>Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.</p>	<p>“Albanian University” mbështet idetë inovatore të studentëve, krijon mundësi për zbatime të avancuara dhe mbështet botimet e projekteve kërkimore të suksesshme.</p> <p><i>Evidencë 2.12.c Axhenda - Konferenca - IIST – 2019- 2021; Evidencë 1.5.a Plani strategjik institucional 2017 – 2022.</i></p>
<p>Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>GVJ konstaton se “Albanian University” implementon disa projekte Erasmus+ me Arctic Centre for Sustainable Energy (ARC), pjesë e Universitetit Arktik të Norvegjisë, me interes të veçantë për studentët e programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Elektrike”. Nëpërmjet tyre institucioni mundëson rritjen e shkëmbimit të eksperiencës dhe përfitimin prej</p>

	<p>praktikave më të mira të institucioneve bashkëpunuese perëndimore, njohuri të cilat më pas aplikohen në auditor apo transferohen tek anëtarë të tjerë të personelit akademik. Brenda vendit organizohen vizita bashkëpunuese. Këto bashkëpunime kanë mundësuar zhvillimin e vizitave në institucione me interes për studentët e këtij programi, si: vizita në HEC-in e Fierzës.</p> <p><i>Evidencë 1.1.a,b,c,d Raporti vjetor - DI - 2018– 2022; Evidencë 3.5.b Marreveshje bashkëpunimi HEC Fierze.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.8	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>“Albanian University” ka hartuar një rregullore diplomimi, e cila jep në mënyrë të detajuar çdo procedurë që ndiqet për temën e diplomës. Në faqen web publike të universitetit bëhet publike kjo procedurë. Studentët me mesatare mbi 8 mund të përzgjedhin zhvillimin e temës së diplomës, ndërsa studentët që nuk e arrijnë këtë mesatare zhvillojnë një provim final.</p> <p><i>Evidencë 3.9.a Procedurë Diploma Bachelor – v.a. 2021 – 2022.</i> <i>https://albanianuniversity.edu.al/sq/manuali-per-punimin-e-temes-se-diplomes/</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Departamenti i Inxhinierive angazhon stafin akademik të orientojnë studentët në procesin e përmbjlljes së studimeve. Kjo bëhet duke dhënë informacion në lidhje me mënyrën (provim final ose temë diplome), si dhe japin udhëzime (në rastin e provimit final) dhe literaturë shtesë (në rastin e temës së diplomës). Studentët deklaruan se po asistoheshin nga udhëheqësit e temës. Dokumenti udhëzues përcakton se është udhëheqësi i diplomës që drejton, këshillon e konsulton.</p> <p><i>Evidencë 3.9.a Procedurë Diploma Bachelor – v.a. 2021 – 2022; Vizita në Institucion, takimi me studentët e programit.</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Provimi final teston konceptet themelore dhe njohuritë e marra gjatë 3 viteve akademike. Teza e provimit përbëhet nga pyetje me zhvillim e alternativa, nga lëndët profesionale kryesore dhe mbi bazën e peshës specifike që ka patur në programin e studimit.</p> <p><i>Evidencë 3.9.a Procedurë Diploma Bachelor – v.a. 2021 – 2022; Evidencë 3.9.b Shembull Procedurë Diplome BSc. IEK - v.a. 2020 – 2021; Evidencë 3.12 Shembull teze provim formimi BSc. IEK - v.a. 2020 – 2021.</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.</p>	<p>Nga vizita në AU në takimin me studentët dhe me stafin akademik të këtij programi studimi, të dy palët konfirmuan se studentët ndihmohen përmes orientimeve të vazhdueshme, informacioneve e literaturës në procesin e përmbjlljes së studimeve. Rregullorja mësimore përcakton se është</p>

	<p>udhëheqësi i diplomës që drejton, këshillon e konsulton. Studentët deklaruan se ishin orientuar për temat që duhet të zgjidhnin.</p> <p><i>Evidencë 3.9.a Procedurë Diploma Bachelor – v.a. 2021 – 2022 Evidencë 3.9.b Shembull Procedurë Diplome BSc. IEK - v.a. 2020 - 2021 Evidencë H.1 Rregullore mesimore BSc. IE 2019; Vizita në Institucion, takimi me studentët e programit dhe personelin akademik.</i></p>				
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Institucioni vë në dispozicion ambientet e tij (laboratorët) ose lehtëson aksesin në ambientet e institucioneve bashkëpunuese në mbështetje të realizimit praktik të punimit të diplomës.</p> <p><i>Evidencë 3.7 Planimetritë - Godina e Rr. Kavajës – 2020.</i></p>				
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Studentët mbështeten nga udhëheqësi i temës edhe në aspektin metodologjik të punës së tyre për hartimin dhe paraqitjen e punimit të diplomës. Departamenti përcakton dhe afishon grafikun e kontrollit të masës së realizimit të punës nga ana e studentit. Udhëheqësi i temës bën një vlerësim të punimit i cili merret në konsideratë nga komisioni.</p> <p><i>Evidencë H.1 Rregullore mesimore BSc. IE 2019; Evidencë 3.9.a Procedurë Diploma Bachelor – v.a. 2021 – 2022; Evidencë 3.9.b Shembull Procedurë Diplome BSc. IEK - v.a. 2020 – 2021.</i></p>				
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studentit vlerësohet me notë.</p>	<p>Punimi i diplomës vlerësohet me notë, e cila është mesatare e vlerësimit të anëtarëve të komisionit të vlerësimit. Vlerësimet me notë janë nga 1 në 10, ku nota më e ulët për kalim është 5.</p> <p><i>Evidencë 3.9.a Procedurë Diploma Bachelor – v.a. 2021 – 2022; Evidencë 3.9.b Shembull Procedurë Diplome BSc. IEK - v.a. 2020 – 2021.</i></p>				
<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Bazuar në procedurën e diplomimit studentit pajiset me diplomën përkatëse dhe suplementin e saj të miratuar nga Senati Akademik i “Albanian University”, ne përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.</p> <p><i>Evidencë 3.9.a Procedurë Diploma Bachelor – v.a. 2021 – 2022; Evidencë 3.9.b Shembull Procedurë Diplome BSc. IEK - v.a. 2020 – 2021; Evidencë E.2 Diploma - BSc. IE; Evidencë E.4 Suplementi- BSc. IE.</i></p>				
<p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, institucioni vendos në dispozicion të studentëve një kopje të plotë zyrtare të programit të studimit të zhvilluar, sipas vitit akademik përkatës, në rastet kur ai e kërkon këtë gjë.</p> <p><i>Evidencë 3.13 Shembull procedure kërkesë programi mësimor dhe syllabuset e lëndëve; Vizita në Institucion, takimi me studentët e programit.</i></p>				
<p>Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.</p>	<p>Sipas RVB, AU mban një kopje të dokumentacionit të studentit për një periudhë të pacaktuar me qëllim pajisjen e studentëve me informacione nëse kërkohen.</p> <p><i>Evidencë 4.2 Rregullore e sekretarisë mësimore; Vizita në Institucion, takimi në sekretarinë mësimore.</i></p>				
	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përbushet</td> <td>Përbushet pjesërisht</td> <td>Përbushet kryesisht</td> <td>Përbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht		

Shkalla e përmbushjes së standardit				X
-------------------------------------	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Bazuar në organigramën e Institucionit, AU ka në strukturën e tij Zyrën e Burimeve Njerëzore, e cila është përgjegjëse për dokumentimin dhe ndjekjen procedurale të të gjithë stafit akademik dhe administrativ të angazhuar në institucion. Gjatë vizitës në zyrën e Burimeve Njerëzore, GVJ konstaton se kjo zyrë dispononte të dhëna mbi anëtarët e personelit akademik dhe ndihmës akademik të angazhuar në programin e studimit.</p> <p>Në shqyrtimin e dy dosjeve rastësore të personelit të angazhuar në programin e studimit, u vu re plotësia dhe rifreskimi i dokumentacionit sipas kërkesave ligjore në fuqi.</p> <p>Dosjet e kontrolluara përmbanin: ID, CV, librezë shëndetësore, format aplikimi, kontratë mes palëve, certifikata të titujve dhe gradave shkencore me njehësimet përkatëse të ministrisë përgjegjëse për arsimin në rastin kur janë lëshuar nga institucione të huaja.</p> <p>Nga Zyra e Burimeve Njerëzore vihet re një organizim i mirë i informacionit të brendshëm e cila bazohet në një sistem informatik si për regjistrimin e dosjeve dhe të dhënave digjitale, ashtu edhe për referenca praktike në ato fizike dhe vendndodhjen e tyre në arkivë. Institucioni ruan informacionet lidhur me stafin akademik dhe personelin ndihmës mësimor - shkencor dhe ngarkesën përkatëse për çdo semestër të vitit akademik.</p> <p><i>Evidencë R.1 a,b Procedurë rekrutimi e stafit akademik; Vizita në Institucion, takimi me Zyrën e Burimeve Njerëzore.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Në fillim të çdo viti akademik, bazuar në nevojat për personel akademik, Departamenti i Inxhinierive, në përputhje me rregulloren e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike në AU, i paraqet Dekanit të Fakultetit kërkesat për plotësimin e vendeve vakante. Bazuar në këtë rregullore, nevojat për staf paraqiten nga departamentet përkatëse të cilët përcaktojnë edhe kualifikimet apo kriteret që kërkohen nga stafi i ri. Këto akte rregullatore janë publike në faqen zyrtare ueb të institucionit.</p>


	<p>Vlerësimi i kandidatëve bëhet përmes Komisionit të Vlerësimit, pjesë e të cilit janë përfaqësues të njësisë bazë dhe kryesore.</p> <p>Me vendim të Senatit Akademik, prej v.a 2017 – 2018, procedurat e rekrutimit mund të hapen edhe para fillimit të semestrit të dytë.</p> <p><i>Evidencë 1.7, Rregullore e Fakultetit (FSHAE); Evidencë R.1 a,b Procedurë rekrutimi e stafit akademik.</i></p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Bazuar në nevojat për personel akademik, në fillim të çdo viti akademik, Departamenti i Inxhinierive i paraqet Dekanatit të Fakultetit kërkesat për plotësimin e vendeve vakante bashkë me kriteret e pranimit (të përgjithshme dhe specifike). Dekanati i Fakultetit ia përcjell këto kërkesa Rektoratit, i cili përcakton dhe procedurat e konkurrimit. Më pas, Zyra e Burimeve Njerëzore publikon vendet vakante dhe kriteret e punësimit për çdo pozicion pune vakant në faqen e internetit të AU, si dhe në mjetet e tjera të informimit publik që disponon IAL.</p> <p><i>Evidencë 1.7, Rregullore e Fakultetit (FSHAE); Evidencë R.1 a,b Procedurë rekrutimi e stafit akademik;</i> https://albanianuniversity.edu.al/sq/?s=vende+vakante</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Në Statutin e Albanian University dhe Rregulloren e FSHAE përcaktohen kriteret e përgjithshme që kandidatët konkurrues duhet të përmbushin:</p> <ul style="list-style-type: none"> • diplomimi i përshtatshëm për vendin e punës së kërkuar; • formimi i përgjithshëm arsimor / profesional; • kualifikimi (gradat shkencore ose titujt akademikë) dhe rezultatet e kërkimit shkencor brenda dhe jashtë vendit; • përvoja pedagogjike dhe eksperiencia të mëparshme në universitet; • zotërimi i aftësive të nevojshme personale për vendin e punës. <p>Zyra e Burimeve Njerëzore në AU ndjek të gjithë procedurën administrative për rekrutimin e stafit të ri. Njoftimet për vende vakante së bashku me kriteret specifike akademike të hartuara nga departamentet, bëhen publike në faqen ueb të Zyrës së Burimeve Njerëzore. Nga konsultimi i informacionit të publikuar në faqen zyrtare të IAL rezultoni njoftime aktive për personel akademik.</p> <p>Bazuar në aplikimet e mundshme dhe shqyrtimin e dokumentacioneve të paraqitura nga kandidatët, Zyra e Burimeve Njerëzore kryen një vlerësim paraprak të tyre në lidhje me plotësinë e dokumentacionit. Më tej, Komisioni i Vlerësimit shqyrton kandidaturat dhe i propozon Dekanit për miratim kandidatët e përzgjedhur, sipas një renditje të kandidatëve që plotësojnë më mirë kriteret dhe përshkrimin e vendit të punës.</p> <p><i>Evidencë 1.2 Statuti i AU; Evidencë R.1 a,b, Procedurë rekrutimi e stafit akademik; Evidencë 1.7, Rregullore e Fakultetit (FSHAE);</i> https://albanianuniversity.edu.al/sq/?s=vende+vakante</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi IV.2**Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																			
<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Departamenti i Inxhinierive në FSHAE në Albanian University zhvillon aktivitetin në mesin që ndodhet në Rrugën e Kavajës. Ambientet e kësaj godine universitare përfshijnë ambiente zyresh për stafin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, ambiente mësimdhënieje (salla leksioni dhe seminari), ambiente laboratorike, bibliotekë, dhe ambiente të tjera ndihmëse dhe shpërndarëse. AU ka vënë në dispozicion të stafit akademik dhe atij administrativ, ambiente të dedikuara, si dhe instrumentat e nevojshëm (kompjutera, kancelari etj.) për mbarëvajtjen e aktiviteteve mësimore dhe administrative .</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, përtej paraqitjes në DVV, vihet re që të gjitha ambientet në funksion jo vetëm të këtij programi studimi, kanë të gjitha kushtet e nevojshme për zhvillimin efektiv të të gjithë procesit didaktik.</p> <p>AU ka vënë në dispozicion të studentëve/ stafit një bibliotekë me literaturë në gjuhë të huaj, kryesisht anglisht, të dedikuar për programet e ndryshme të studimit.</p> <p><i>Evidencë Aneks tabela - RVB - BSc. IEK – 2022, Tabelat 16 dhe 17; Vizita në ambientet e Institucionit.</i></p>																																			
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Gjatë takimeve në institucion, në veçanti me stafin akademik, me përfaqësues të zyrës së sigurimit të cilësisë dhe në takimin me drejtues të institucionit dhe të programit të studimit, u nënvizua zbatimi i politikave mbështetëse dhe promovuese të zbatuara nga IAL. Politikat promovuese janë të sanksionuara edhe në direktiva të brendshme të institucionit si Plani strategjik i zhvillimit të IAL 2017-2022, Rregullorja e DI. Nisur nga të dhënat e tabelës, publikimet e PAE të Departamentit, ndër vite, paraqiten si në vijim: v.a. 2018- 2019 – 38; v.a. 2019-2020 – 41, rritje me 8% krahasuar me vitin paraardhës; v.a. 2020-2021, 31, rënie me 25% krahasuar me vitin paraardhës.</p> <table border="1" data-bbox="622 1467 1460 1982"> <thead> <tr> <th></th> <th>Viti akademik</th> <th>2018 - 2019</th> <th>2019 – 2020</th> <th>2020 - 2021</th> <th>2021 - 2022</th> <th>Gjithsej</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i Departamentit</td> <td>38</td> <td>41</td> <td>31</td> <td>-</td> <td>110</td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>Numri i projekteve kërkimore të fituara në shkallë Departamenti/Fakulteti</td> <td>2</td> <td>5</td> <td>5</td> <td>5</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>Numri i projekteve të zbatuara në shkallë Departamenti/Fakulteti</td> <td>1</td> <td>15</td> <td>05</td> <td>5</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>4</td> <td>Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga Departamenti/Fakulteti dhe IAL, për programin e studimit</td> <td>14</td> <td>7</td> <td>8</td> <td>3</td> <td>14</td> </tr> </tbody> </table>		Viti akademik	2018 - 2019	2019 – 2020	2020 - 2021	2021 - 2022	Gjithsej	1	Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i Departamentit	38	41	31	-	110	2	Numri i projekteve kërkimore të fituara në shkallë Departamenti/Fakulteti	2	5	5	5	2	3	Numri i projekteve të zbatuara në shkallë Departamenti/Fakulteti	1	15	05	5	1	4	Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga Departamenti/Fakulteti dhe IAL, për programin e studimit	14	7	8	3	14
	Viti akademik	2018 - 2019	2019 – 2020	2020 - 2021	2021 - 2022	Gjithsej																														
1	Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i Departamentit	38	41	31	-	110																														
2	Numri i projekteve kërkimore të fituara në shkallë Departamenti/Fakulteti	2	5	5	5	2																														
3	Numri i projekteve të zbatuara në shkallë Departamenti/Fakulteti	1	15	05	5	1																														
4	Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga Departamenti/Fakulteti dhe IAL, për programin e studimit	14	7	8	3	14																														



	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="606 239 686 347">5</td> <td data-bbox="686 239 949 347">Numri i pjesëmarrësve në aktivitetet shkencore</td> <td data-bbox="949 239 1045 347">138</td> <td data-bbox="1045 239 1149 347">99</td> <td data-bbox="1149 239 1252 347">144</td> <td data-bbox="1252 239 1356 347">91</td> <td data-bbox="1356 239 1471 347">138</td> </tr> <tr> <td data-bbox="606 347 686 436">6</td> <td data-bbox="686 347 949 436">Numri i Çmimeve Kombëtare të fituara në rang IAL</td> <td data-bbox="949 347 1045 436">0</td> <td data-bbox="1045 347 1149 436">0</td> <td data-bbox="1149 347 1252 436">0</td> <td data-bbox="1252 347 1356 436">0</td> <td data-bbox="1356 347 1471 436">0</td> </tr> </table>	5	Numri i pjesëmarrësve në aktivitetet shkencore	138	99	144	91	138	6	Numri i Çmimeve Kombëtare të fituara në rang IAL	0	0	0	0	0
5	Numri i pjesëmarrësve në aktivitetet shkencore	138	99	144	91	138									
6	Numri i Çmimeve Kombëtare të fituara në rang IAL	0	0	0	0	0									
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Nga institucioni bëhen përpjekje për të motivuar stafin duke financuar arritjet e stafit në publikime shkencore dhe pjesëmarrje në projekte.</p> <p><i>RVB, Tabelat përmbledhëse, Tabela 19; Evidencë 1.5 a Plani strategjik institucional 2017-2022, Evidencë 2.2 rregullore e Departamentit DI; Vizita në Institucion, takimi me stafin akademik, përfaqësues të zyrës së sigurimit të cilësisë, drejtues të institucionit dhe të programit të studimit.</i></p> <p>AU inkurajon përdorimin e metodave inovative në mësimdhënie. Kjo vërehet edhe në angazhimin e institucionit për të mbështetur me infrastrukturën e nevojshme në zhvillimin modern të mësimdhënies.</p> <p>Në periudhën e vështirësive objektive për të gjitha IAL-të, si pasojë e situatës së krijuar nga pandemia e SARS-Cov-2, AU ka rritur angazhimin në përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies duke krijuar infrastrukturën e nevojshme për mësimdhënie online direkt nga auditorët e shkollës. Gjithashtu, së bashku me mësimdhënien klasike, një pjesë e leksioneve të regjistruara nga stafi akademik, bëhen publike dhe në platformën Microsoft Teams, e aksesueshme nga studentët por jo vetëm.</p> <p>Gjithashtu, në kuadër të rritjes së cilësisë së brendshme në mësimdhënie dhe kërkimit shkencor organizohen aktivitete të ndryshme trajnuese.</p> <p>“Teknologjia dhe Mësimdhënia” janë në qendër të kërkimit shkencor të Departamentit të Inxhinierive, prandaj metodat inovative në mësimdhënie të lidhura me teknologjitë e informacionit janë paraqitur në aplikime projektsh kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>Gjatë periudhës së pandemisë Covid – 19 dhe në vazhdim, AU ka zhvilluar trajnime të ndryshme për përdorimin e instrumentave informatikë në funksion të mësimdhënies dhe ka përgatitur udhëzues të ndryshëm të vënë në dispozicion të pedagogëve dhe studentëve.</p> <p><i>Evidencë 3.2.a, Manual për realizimin e mësimit online 2020 – 2021; Evidencë 3.2.b, Manuali i provimeve online 2020 – 2021; Evidencë 3.2.c, Udhëzues video për përdorimin e platformës Microsoft Teams; Evidencë 1.1.a-1.1.d, Raportet vjetore DI.</i></p>														
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Të dhënat mbi ngarkesën totale të stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi, duke përfshirë edhe ngarkesën në programe të tjera studimi të institucionit për vitin aktual akademik (2021-2022), paraqiten si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Staf i PAE: Ngarkesa në orë (min – max) është 175 - 1003, ndërsa ngarkesa mesatare në orë është 480; • Staf i PAK: Ngarkesa në orë (min – max) është 23 – 331, ndërsa ngarkesa mesatare në orë është 137. <p>Bazuar në Udhëzim nr. 29, dt. 10.09.2018 i Ministrisë përgjegjëse për arsimin, Kreu III, pika 5, IAL nuk ka një kufizim ligjor mbi ngarkesën maksimale të</p>														




	<p>lejuar për stafin akademik në IAL jopublike. Megjithatë, <i>ngarkesa mësimore e personelit akademik efektiv është kryesisht tepër e lartë, rreth 69% e tyre kanë ngarkesë më shumë se 400 orë mësimore, ku maksimumi shkon 1003 orë. Ky fakt nuk i vjen në ndihmë përpjekjeve që AU bën për rritjen e cilësisë në mësimdhënie.</i></p> <p>Personeli akademik dhe ai ndihmës akademik i angazhuar në këtë program studimi ka formimin e kërkuar dhe të nevojshëm për lëndët që mbulon. Kjo duket edhe nga analiza e të dhënave në tabelat 6.1-6.6 <i>Tabelat përmbledhëse të RVB dhe formimin e stafit përkatës siç jepet në CV-të e tyre.</i></p> <p><i>GVJ rekomandon që ngarkesa e stafit akademik të zvogëlohet në mënyrë që të garantohet një mësimdhënie dhe mësimnxënie sa më cilësore. Në këtë mënyrë mund të rritet angazhimi i stafit në projekte kërkimore ku përfshihen e kërkimeve dhe njohurive do të mund të pasqyrohen edhe në dijet e përçuara tek studentët.</i></p> <p>Departamenti i Inxhinierive ka në përbërje të tij :</p> <ul style="list-style-type: none"> • 2 anëtarë të personelit ndihmës - akademik me karakter mësimor (laborantë) me eksperiencë në fushën përkatëse që mbikëqyrin mbarëvajtjen e punëve laboratorike dhe kujdesen për mirëmbajtjen e laboratorëve; • 1 asistente departamenti dhe • 2 sekretare mësimore për programet e studimit <i>Bachelor</i> dhe <i>Master</i> nën kujdesin e kryesekretares së Fakultetit; • 1 punonjëse biblioteke, e cila mbikëqyr bibliotekën, ndihmon dhe orienton studentët në përdorimin optimal të materialeve mësimore të ofruara. <p><i>RVB, Tabelat përmbledhëse.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	<p>Në shërbim të programit të studimit Departamenti i Inxhinierive ka vënë në dispozicion një ndërtesë në Rugën e Kavajës, e rikonstruktuar dhe e përshtatur për universitetin, me salla leksionesh, seminaresh dhe laboratorë. Bazuar në informacionin e paraqitur në DVV si dhe nga evidentimi gjatë vizitës në institucion, u konstatua se Albanian University siguron mjediset të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse përkatësisht afro 3.26 m² për student dhe 4.58 m² për personelin. <i>Mbështetur në Vendim Nr. 418, datë 10.5.2017 "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit"</i></p>

	<p><i>të lartë dhe të degëve të tyre”, në Aneks 1, pika C: Normativa e sipërfaqes së shfrytëzueshme, për objektet që do të ofrohen nga IAL me programe studimi “Inxhinieri dhe teknologji” është 5m² për student. Pra, vihet re se ambientet që AU ofron për programet e studimit të Departamentit të Inxhinierive janë të pamjaftueshme.</i></p> <p><i>Evidencë 3.7, Planimetritë e godinës Rr. Kavajës; Aneks tabela - RVB - BSc. IEK – 2022, Tabela 16; Vizita në ambientet e Institucionit.</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ vizitoi ambientet si salla leksionesh dhe seminaresh, laboratorët, bibliotekën dhe mjediset ndihmëse. Sallat e leksioneve dhe seminareve ishin të pajisura me video-projektor dhe PC fiks në ndihmë të procesit mësimor.</p> <p>Sallat janë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme dhe me mjetet e nevojshme teknologjike: kompjuter, videoprojektor etj. në funksion të mësimdhënies. E gjithë godina mbulohet nga rrjet interneti <i>wireless</i>, e disponueshme për të gjithë. Stafi i IT mirëmban dhe asiston stafin akademik në mirëpërdorimin e pajisjeve teknologjike të vëna në dispozicion.</p> <p><i>Evidencë 3.7, Planimetritë e godinës Rr. Kavajës; Aneks tabela - RVB - BSc. IEK – 2022, Tabela 16; Vizita në ambientet e Institucionit.</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Departamenti i Inxhinierive në funksion të programeve të studimit ka ngritur laboratorët mësimore si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Laboratorët e Informatikës 1 – 2 (Simulimeve); • Laboratori i Infrastrukturës së Rrjetave; • Laboratori i Fizikës; • Laboratori i Kimisë; • Laboratori i Elektroteknikës; • Laboratori i elektronikës analoge\ elektronikës dixhitale; • Laboratori i matjeve elektrike dhe elektronike; • Laboratori i automatikës dhe kontrollit (dhe Mekatronikës); • Laboratori i makinave elektrike. <p>Në laboratorët e informatikës (simulimeve) janë të instaluarat programet (<i>software</i>) e nevojshme në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve në fushat inxhinierike, që azhurnohen vazhdimisht. Kompjuterët e këtyre laboratorëve paraqesin karakteristika teknike të mjaftueshme për të përballuar ngarkesën e kërkuar në simulime dhe aktivitete laboratorike të këtij programi studimi. Laboratorët janë të pajisur me aparatura dhe mjete mësimore bashkëkohore, të mjaftueshme për kryerjen e orëve laboratorike ku studentët asistohen prej pedagogut të laboratoreve dhe laborantit. Laboratorët janë të disponueshëm për studentët gjatë orëve të mësimin, për përgatitjen e detyrave të kursit, diplomave etj. Në fillim të vitit akademik 2019 – 2020, AU i zëvendësoi kompjuterat ekzistues të Laboratorit të Informatikës 1 me kompjutera të rinj, me parametra në përputhje me nevojat e <i>software</i> të programeve mësimore të ofruara.</p> <p><i>Evidencë 1.6, Përshkrimi i laboratoreve; Vizita në ambientet e Institucionit.</i></p>

<p>Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>Institucioni ofron 2 laboratorë të teknologjisë së informacionit të cilët kanë të instaluar programe në funksion të programit të studimit, me kompjutera me karakteristika teknike të mjaftueshme për të përballuar ngarkesën e kërkuar në simulime dhe aktivitete laboratorike të këtij programi studimi.</p> <p>Nga biseda me studentët, këto laboratorë aksesohen prej tyre jo vetëm gjatë orëve të parashikuara për lëndët përkatëse, por mund të aksesohen sa herë e kanë të nevojshme.</p> <p><i>Evidencë 27, Përshkrimi i laboratorëve; Vizita në ambientet e Institucionit dhe takimi me studentët.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>	<p>Për realizimin e veprimtarive praktike e profesionale institucioni vë në dispozicion jo vetëm mjediset e tij por edhe ato të ofruara nga institucionet me të cilat bashkëpunon. AU ka një numër të mjaftueshëm marrëveshesh me subjekte private në fushën e inxhinierisë elektrike që të mundësojë praktikatat profesionale të studentëve.</p> <p>Gjithashtu, vihet re një angazhim në rritje të institucionit për të marrë pjesë në projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare dhe ku pjesëmarrja në këto projekte shihet si pozitive në tërësi për rritjen e nivelit të institucionit, stafit dhe studentëve. Në veçanti për studentët e këtij programi studimi shihet si mundësi e mirë për zhvillimin e veprimtarive praktike, profesionale dhe kërkimit shkencor në nivele kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p><i>Tabelat përmbledhëse, tabela 5; Vizita në ambientet e Institucionit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi IV.4 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Inxhinierive, në godinën e Rrugën së Kavajës, për studentët e programeve të studimit <i>Bachelor, Master i Shkencave dhe Master Profesional</i>, disponon një ambjent të dedikuar për bibliotekën mësimore. Ky ambjent i bibliotekës ofron hapësira për lexim dhe studim nga ana e studentëve. Në bibliotekë janë të instaluara 25 terminale të lidhura në një kompjuter qendror, të cilët vihen në dispozicion të studentëve.</p> <p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni dhe vizitën në institucion, AU për FSHAE ka një bibliotekë me sipërfaqe rreth 62m², të pajisur me një fond librash, kryesisht në gjuhën angleze por jo vetëm. Biblioteka e FshAE ka 120 tituj librash në fushat inxhinierike me 398 kopje. Në bibliotekë gjendet rreth 80% e literaturës së detyruar në gjuhën shqipe, e paraqitur në syllabuset e lëndëve Të dhënat e bibliotekës mund të aksesohen online nga i gjithë stafi dhe studentët në adresën ueb:</p> <p>https://albanianuniversity.edu.al/sq/bibloteka/</p> <p>https://albanianuniversity.edu.al/sq/bibloteka-online/</p>



	<p>https://albanianuniversity.edu.al/sq/libraria/</p> <p>Në portalin www.portal.getty.edu ofrohen rreth 100.000 volume librash të vëna në dispozicion nga një sërë universitetesh në mbarë botën nga të cilat 6.400 janë vetëm mbi arkitekturën. Ndërsa në bibliotekën on line www.elsevier.com ofrohen për studentët 46 907 tituj librash dhe 2221 gazeta. Biblioteka ka hapësira të mjaftueshme për konsultimin e literaturës fizike me rreth 25 vende (tavolinë/ karrige) për konsultim.</p> <p><i>Evidencë 3.8, Lista e librave në bibliotekë 2022; Vizita në bibliotekën e Institucionit.</i></p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka e FShAE disponon 120 tituj librash në fushat inxhinierike me 398 kopje, nga të cilat 80% janë pjesë e literaturës së detyruar në gjuhën shqipe, e paraqitur në syllabuset e lëndëve. <i>Pak tituj gjenden në kopje të mjaftueshme dhe në edicionet e tyre më të fundit. Shumica e titujve të literaturave të rekomanduara në syllabuse nuk gjendet në bibliotekë dhe nuk është e 5 viteve të fundit.</i></p> <p>Literatura e ofruar, si në formë <i>hardcopy</i>, në format elektronik dhe <i>online</i>, ndihmojnë studentët në kryerjen e projekteve e detyrave të kërkuara nga pedagogët në kuadër të mësimdhënies dhe në përgatitjen e tezës së diplomës. <i>GVJ rekomandon se është e nevojshme që në vazhdimësi të pasurohet literatura fizike për lëndët e programit të studimit në përputhje me programet e azhornuara të lëndëve.</i></p> <p><i>Evidencë 3.8, Lista e librave në bibliotekë 2022; Evidencë R.4, Syllabuset e lëndëve Beh IE; Vizita në bibliotekën e Institucionit.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>AU ka në dispozicion të studentëve një sërë librarish <i>online</i>, të cilat janë të aksesueshme pa pagesë për të gjithë studentët e interesuar nën kujdesin e punonjësës së bibliotekës në qendrën e internetit. Libraritë <i>online</i> të këshilluara janë me drejtim kryesisht inxhinierik.</p> <p>https://albanianuniversity.edu.al/sq/libraria/</p> <p><i>RVB, Tabelat përmbledhëse, Tabela 17.</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Biblioteka ofron kushtet logjistike për një përdorim efikas të ambienteve. Ambienti është <i>open-space</i> me libra në raftë të organizuara sipas klasifikimit LC (ndarje sipas argumenteve të trajtuar).</p> <p>Ofrohen rreth 25 poste konsultimi. Ambienti është i pajisur edhe me PC me qasje në internet dhe me mundësi për të përdorur bibliotekën virtuale nga të gjithë studentët dhe stafi.</p> <p>Gjithsesi, biblioteka dhe koleksionet online mund të aksesohen si nga studentët ashtu edhe nga stafi, nga çdo vend (IAL apo edhe nga shtëpia) me kredenciale aksesit të autorizuar nga institucioni.</p> <p><i>RVB, Tabelat përmbledhëse, Tabela 17; Vizita në ambientet e Institucionit.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>AU ka një procedurë të brendshme për planifikimin dhe shtimin e fondit të librave/revistave dhe materialeve të tjera të bibliotekës. Kryesisht procedura për shtimin e zërave të bibliotekës nis çdo fillim viti akademik, në përputhje edhe me rishikimet e syllabuseve. Departamenti bën kërkesat e tij për shtimin e librave në bibliotekë, si në tituj edhe në numër. Procedura më pas ndiqet nga zyrat përkatëse për prokurimet.</p>

	<p>GVJ rekomandon se AU duhet të hartojë dhe zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës dhe përditësimin e fondit ekzistues për programin e studimit Bachelor në "Inxhinieri Elektrike" sipas nevojave dhe kërkesave për këtë program studimi.</p> <p><i>Evidencë 2.7, Kërkesë pasurimi e bibliotekës.</i></p>			
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Oraret e punës së bibliotekave në AU janë të disponueshme për studentët nga dita e hënë deri ditën e premte në orën 08.00 – 16.00 si dhe ditën e shtunë ora 08.00 – 12.00. Studentët regjistrohen në kartelat që iu lejon të marrin librat në ambjentet e sallave të studimit brenda universitetit. Qasja në bibliotekën fizike është i mundur 6 ditë në javë me orare të afishuara publikisht si në hyrje të bibliotekës ashtu edhe në faqen ueb përkatëse.</p> <p>https://albanianuniversity.edu.al/sq/biblioteka/</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

<p>Standardi IV.5 Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>AU disponon dhe përdor sekretarinë <i>online</i> Pitagora (http://au.pitagora.rash.al/), të vënë në dispozicion nga RASH. Sekretaria mësimore përgjigjet për ruajtjen, menaxhimin dhe përditësimin periodik të të dhënave të studentëve nga regjistrimi deri në diplomim. Çdo student ka llogarinë e tij, ku mund të logohet me kredencialet personale dhe të marrë informacionin personal në lidhje me të dhënat e tij të perditësuara, rezultatet e arritura, lëndët të cilat duhet të frekuentojë etj.</p> <p><i>Evidencë 73, Rregullore e sekretarisë mësimore; Vizita në institucion.</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Departamenti ruan në formë hardcopy informacionet që lidhen me aktivitetin e personelit akademik dhe ndihmës akademik. Zyra e Burimeve Njerëzore ruan informacionet e dokumentuara për punësimet e personelit akademik efektiv dhe të ftuar, ndihmës akademik dhe administrativ. Informacionet lidhur me partnerët e programit të studimit ruhen në Departament dhe në zyrat përkatëse: Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët, Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, Zyra e Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike etj. AU nuk disponon ndonjë sistem të brendshëm menaxhimi që përmes një platforme të informatizuar të administrojë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me sekretarinë mësimore.</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të</p>	<p>Studentët përmes sekretarisë <i>online</i> mund të aksesojnë në kohë reale të dhënat e tyre të perditësuara, rezultatet e arritura, lëndët, të cilat duhet të frekuentojnë etj. Personeli akademik dhe studentët mundësojnë komunikimin e tyre në</p>

gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	mënyrë efektive përmes platformës Office 365 të Microsoft në shërbim të mësimdhënies. Për personelin akademik, ndihmësakademik dhe administrativ nuk mundësohet akses i dedikuar në informacione dhe dokumentacion përmes një sistemi menaxhimi.			
	<i>Vizita në institucion, takimi me sekretarinë mësimore.</i>			
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Stafi akademik, ai administrativ dhe studentët disponojnë <i>email</i> -et zyrtare të Institucionit, bashkë me të cilët ofrohet paketa Office 365. Aplikacionet e kësaj pakete mundësojnë ruajtjen dhe shpërndarjen e informacionit, si dhe komunikimin interaktiv në kohë reale ndërmjet përdoruesve.			
	<i>Vizita në institucion, takimi me stafin akademik dhe takimi me sekretarinë mësimore.</i>			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Në sistemin e informatizuar janë të dhënat dhe arritjet akademike të studentëve si nota, praktika, herët që një student ka dhenë një provim të caktuar etj. Bazuar në këto të dhëna, sistemi është në gjendje në mënyrë të automatizuar ti përpunojë dhe të krijojë raporte përmbledhëse: mbi kalueshmërinë, apo vlerësimin mesatar të studentëve.			
	<i>Vizita në institucion, takimi me sekretarinë mësimore.</i>			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Në faqen zyrtare të AU ka informacione që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme akademike e studentore, bibliotekën, etj. Në të publikohen dokumenti si Statuti, rregullore, raporte vlerësime, vendime Senati, Vendime Bordi etj, njoftime për vendet vakante, njoftime për kriteret e regjistrimit, fitimit të bursave, tarifave të shkollimit etj, në dy gjuhë, anglisht dhe shqip.			
	https://albanianuniversity.edu.al/			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.6	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Albanian University harton një raport të përvitshëm financiar në nivel institucioni, të cilin e çertifikon edhe me auditues të jashtëm. Në këtë raport paraqiten të ardhurat dhe shpenzimet që institucioni kryen. <i>Ky raport nuk paraqet kostot individuale të programeve të studimit dhe as planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</i> Në të dhënat e deklaruara në raportet vjetore institucionale në nivel departamenti, për vitet akademike nga 2018-2021 dhe tabelën 18, kemi një

	<p>përmbledhje të shpenzimeve operative për secilin vitin akademik në rang institucional.</p> <p><i>Evidencë, Raporte 2018-2021; RVB tabela përmbledhëse, tabela 18.</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Burimet financiare të universitetit janë kryesisht nga tarifat e shkollimit dhe aktivitete të tjera tregtare të përmendura në RVB. Nuk ka informacion të detajuar në lidhje me shpenzimin e të ardhurave. Në rang universiteti ka një njësi e cila merret me menaxhimin e burimeve financiare, dhe kontrollin e tyre. Institucioni ka një raport financiar, bilanc, për çdo vit buxhetor, i cili edhe pse nuk është depozituar në DVV si dokument, është pasqyruar në raportet vjetore të departamentit dhe pasqyrohet përmes të dhënave për të ardhurat nga tarifat e shkollimit, për pagat, sigurimet shëndetësore, sigurimet shoqërore, tatimin mbi të ardhurat personale, shpenzimet operative etj. Kostot operative vjetore ndryshojnë nga njeri program studimi tek tjetri, për shkak të veçorive që ka secili prej tyre. Burimet financiare janë kryesisht nga tarifat e shkollimit të studentëve.</p> <p><i>Vihet re një rritje e të ardhurave nga grantet e fituara prej personelit akademik të programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Elektrike” në kuadër të projektit dypalësh midis Shqipërisë dhe Kosovës “Disenjimi dhe konstruktimi i dorës robotike të komanduar për lëvizje të ndryshme”, projekt i fituar në bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës, Hasan Prishtina, financiar nga AKKSHI. Ky fakt përbën një faktor të rëndësishëm që DI duhet ta zhvillojë edhe në të ardhmen për rritjen e qëndrueshmërisë financiare të DI, FSHAE dhe AU.</i></p> <p>Nuk ka informacion të detajuar për shpenzimet që institucioni bën për qiranë e objektit dhe shërbime të tjera të lidhura me të (mirëmbajtja, pastrimi, ngrohja, ftohja etj.). Një pjesë e burimeve nga të ardhurave shpenzohet për pagesën dhe sigurimet e punonjësve të brendshëm dhe të jashtëm, si dhe për mbulimin e shpenzimeve që lidhen me reklamën, shërbimin internet, pajisjet e aparaturat, mjetet e konsumit dhe detyrimet ndaj shtetit.</p> <p><i>Evidencë Raporte 2018-2021.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Të ardhurat dhe financimet në institucion regjistrohen, përpunohen dhe auditohen sipas formularëve të standardizuar, mbi bazën e një numri unik identifikues (NIPT-i) të lëshuar nga QKR. Në këtë mënyrë treguesit për të ardhurat dhe financimet nuk janë të veçuara për çdo program studimi.</p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me specialisten e financës.</i></p>
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Në vizitën e kryer në Institucion, mësuam se ka raport financiar për çdo vit buxhetor, i cili është certifikuar nga auditues të jashtëm të licencuar, me të dhëna për tarifat e shkollimit, të ardhurat nga shërbime, të ardhura nga grante, shpenzimet për pagat, sigurimet shëndetësore, sigurimet shoqërore, tatimin mbi të ardhurat personale, shpenzimet operative etj.</p> <p>Në dosjen e akreditimit nuk është depozituar ndonjë raport që analizon ecurinë e programit të studimit dhe që planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe</p>

	diversifikimin eventual të financimit të tij për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale, si rrjedhim të dhënat i janë referuar RVB.			
	<i>Vizita në institucion, takimi me specialisten e financës.</i>			
Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	AU ka kapacitete financiare që i gjeneron kryesisht prej tarifës së shkollimit. Të ardhurat e tjera prej aktivitetit tregtar apo granteve zënë vetëm 0.7%-0.8% secila në vitin më të mirë. Ky tregues dëshmon se AU duhet të rrisë përpjekjet për shtimin e të ardhurave sidomos prej granteve në projekte kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombtare. Kjo jo vetëm do rriste qëndrueshmërinë financiare të AU por do të përmirësonte ndjeshëm edhe cilësinë e mësimdhënies dhe rankimin e IAL në plan kombëtar.			
	<i>RVB, Tabelat përmbledhëse, Tabela 18.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	


V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	AU ka të miratur rregulloren bazë të IAL, e cila saktëson të gjithë procedurën administrative nga pranimi i studentëve deri në diplomimin e tyre dhe marrjen e diplomës përkatëse. Rregullorja është publike dhe e aksesueshme në ueb në adresën https://albaniamuniversity.edu.al/sq/rregullore/ . <i>Evidencë 1.3 Rregullore AU; Evidencë H.1, Rregullore e programit të studimit Bachelor IE.</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	AU bazuar në Statut, në veçanti në nenin 47 dhe 73, ka politika dhe procedura të qarta që garantojnë barazinë dhe të drejta të barabarta për të gjithë studentët dhe kandidatët për studentë si për tarifën e shkollimit, fitimin e bursave dhe të drejtave të tjera që ka gjatë shkollimit në AU. Ndër kriteret e barazisë është edhe vlerësimi me meritë për bursat sipas kriterëve që propozohen nga Senati Akademik dhe miratohen nga Bordi i Administrimit.


	<p>Këto informacione dhe të tjera në lidhje me institucionin bëhen publike edhe nëpërmjet fushatave komunikuese dhe marketingu që institucioni harton.</p> <p><i>Evidencë H.1, Rregullore e programit të studimit Bachelor IE; Evidencë 1.2, Statuti i AU.</i></p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>AU, bazuar në udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin, çdo vit publikon kriteret dhe procedurat e aplikimit dhe regjistrimit të studentëve jo vetëm në këtë program studimi, por për të gjithë programet e studimit të ofruara nga institucioni.</p> <p>Kriteret bëhen publike në faqen ueb zyrtare të institucionit në adresën https://albanianuniversity.edu.al/sq/?s=kriteret+e+pranimit, dhe u janë komunikuar para fillimit të vitit akademik studentëve dhe të interesuarve në zyrat përkatëse të institucionit.</p> <p>Në rregulloren mësimore të programit të studimit jepen informacione mbi kriteret dhe procedurat e pranimit të studentëve, vlerësimit të dijeve dhe diplomimit. Në rregulloren e Regjistrimeve dhe Transferimeve jepen informacione të detajuara për njohjen e plotë ose të pjeshme të studimeve të mëparshme. Të gjitha këto informacione vihen në dispozicion të studentëve nga strukturat përkatëse, të cilat janë të disponueshme edhe për sqarime të mëtejshme.</p> <p><i>Evidencë H.1, Rregullore e programit të studimit Bachelor IE; Evidencë 2.4, Rregullore e Regjistrimeve dhe Transferimeve.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Bazuar në udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin, AU ka hartuar kriteret specifike për çdo program studimi të ofruar prej tij. Kriteret bëhen publike në faqen e institucionit si dhe u janë komunikuar para fillimit të vitit akademik studentëve dhe të interesuarve në zyrat përkatëse të institucionit. Kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve në programet e studimit Bachelor të ofruara nga Departamenti i Inxhinierive janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Mesatarja e përgjithshme 70%; ➤ Mesatarja e gruplëndëve 30%; <ul style="list-style-type: none"> – Informatikë 10%; – Matematikë 10%; – Fizikë 10%. <p>Këto kriteret i dërgohen ministrisë përgjegjëse për arsimin në periudhën e kërkuar prej saj. Kriteret bëhen publike në portalin e maturës shtetërore për të gjithë kandidatët. Gjithashtu këto kriteret çdo i interesuar i gjen në faqen web të AU: https://albanianuniversity.edu.al/sq/kriteret-e-pranimit-2/.</p> <p><i>Evidencë H.1, Rregullore e programit të studimit Bachelor IE; Evidencë 2.4, Rregullore e Regjistrimeve dhe Transferimeve.</i></p>
<p>Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë</p>	<p>Aplikimi kryhet nga kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë, dhe janë të pajisur me:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) dokumentacionin ligjor të përfundimit të këtij niveli arsimor; 2) nuk rezultojnë të regjistruar në një program tjetër studimi, në IAL-të publike ose jopublike;

edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	<p>3) plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave;</p> <p>4) plotësojnë kriteret e përcaktuara nga AU për programin e studimit për të cilin aplikojnë.</p> <p>Në programet e ciklit të parë mund të regjistrohen edhe studentë të huaj në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p> <p><i>Evidencë 5, Rregullore e programit të studimit Bachelor IE; Evidencë 2.4, Rregullore e regjistrimeve dhe transferimeve.</i></p>			
Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	<p>AU ka politika dhe udhëzime të brendshme që përcaktojnë mënyrën dhe modelet e komunikimit dhe marrëdhënieve me publikun. Këto informacione dhe të tjera në lidhje me institucionin bëhen publike edhe nëpërmjet fushatave komunikuese dhe marketingu që institucioni harton edhe në institucione arsimore parauniversitare. AU fillon informimin e maturantëve gjatë ditëve të informimit të organizuara nga MASR (ditët e informimit), dhe më pas, në vazhdim, për kandidatët e interesuar për programet e studimit që ofron, me informacione më të detajuara mbi përmbajtjen e programeve të studimit dhe kriteret për pranimin në to.</p> <p><i>Evidencë H.1, Rregullore e programit studimit Bachelor IE; Evidencë 2.4, Rregullore e regjistrimeve dhe transferimeve.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi V.2 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Studentët e programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Elektrike” në AU, bazuar në syllabuset e lëndëve, në statutin e institucionit si dhe në rregulloren e programit të studimit, informohen se vlerësimi i dijeve bazohet në një sistem me notë, konsiderohen kaluese notat 5-10.</p> <p>Institucioni, që në javën orientuese, i njeh studentët me përmbajtjen e programit të studimit dhe rregulloren përkatëse, me vëmendje të veçantë në procedurat e përparimit të tyre akademik dhe kalimit nga një vit në tjetrin. Studenti, i cili në përfundim të vitit akademik nuk merr 50% të lëndëve (së bashku me sesionin e vjeshtës), nuk kalon në vitin akademik pasardhës, por mbetet në stazh. Studenti detyrohet të frekuentojë lëndët e të rifutet në sesionet përkatëse të provimit. Studenti fiton të drejtën e mbrojtjes së diplomës (ose provim formimi), nëse ka shlyer të gjitha detyrimet e prapambetura të programit mësimor.</p> <p>IAL ka vënë në dispozicion të studentëve informacionin e nevojshëm për kriteret dhe procedurat e përparimit akademik në javën e parë të orientimit të organizuar nga fakulteti dhe me pjesëmarrjen e stafit akademik që mbulon</p>



	<p>programin në fjalë, si dhe gjatë orientimit dhe prezantimit të syllabusit të lëndës, nga çdo pedagog, në javën e parë të mësimit. Në të njëjtën kohë syllabuset e lëndëve janë ngarkuar nga secili pedagog në platformat online.</p> <p><i>Evidencë H.1, Rregullore e programit të studimit Bachelor IE; Evidencë R.4 Syllabuset e lëndëve BSc. IE - v.a 2021 – 2022; Evidencë 1.2 Statuti Albanian University.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Institucioni, në zbatim të Udhëzimit Nr. 10 datë 15.05.2019 “Për procedurat e aplikimit dhe dhe të regjistrimit në ILA” dhe Udhëzimit Nr. 17, datë 30.07.2019, të ndryshuar të MASR, ka parashikuar procedurat për njohjen e kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme në rregulloren bazë të IAL. Ka pasur numër të konsiderueshëm transferimesh nga programe të tjerë në këtë program studimi. Procedurat dhe kriteret për transferimin e studimeve dhe njohjen e kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme studenti i gjen në faqen web të AU.</p> <p>Gjithashtu, Zyra e Transferimeve dhe Ekuivalentimeve të Studimeve është përgjegjëse për realizimin e regjistrimeve dhe transferimeve të studimeve, në bashkëpunim të ngushtë me Departamentin. Kjo zyrë njeh studentët e interesuar me procedurat përkatëse për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve.</p> <p><i>Evidencë H.1, Rregullore e programit të studimit Bachelor IE; Evidencë 2.4: Rregullore e regjistrimeve dhe transferimeve; RVB, Tabelat përmbledhëse, Tabela 21; https://albanianuniversity.edu.al/sq/procedura-e-pranim-it-dhe-regjistrimit-te-kandidateve-ge-aplikojne-per-transferime-dhe-programe-te-dyta-studimi/.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në kriteret e kërkuara në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, e ndryshuar, në plan-programet e lëndëve janë të paraqitur mënyrat e vlerësimit të dijeve. Gjithashtu informacione të përgjithshme jepen edhe në rregulloren e programit të studimit (pjesa e provimeve) si për studentët ashtu edhe për lektorët. Gjatë javës së parë të vitit akademik, Institucioni organizon ditët orientuese, gjatë të cilave, stafi akademik, stafi administrativ dhe Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët informojnë studentët mbi procedurat e ndryshme që duhet të ndjekin për mbarëvajtjen e studimeve të tyre. Gjatë orëve të para të mësimit, pedagogët njohin studentët me përmbajtjen e syllabusit të lëndës, në të cilën përfshihen edhe format e vlerësimit konkret për secilën lëndë.</p> <p><i>Evidencë H.1, Rregullore e programit studimit Bachelor IE; Evidencë R.4 Syllabuset e lëndëve BSc. IE - v.a 2021 – 2022.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në AU dhe në veçanti takimi me përfaqësues të studentëve, vihet re një qasje transparente dhe informuese e institucionit kundrejt studentëve. IAL ka informuar studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve të programit, në mënyrë të përgjithshme për infrastrukturën në dispozicion të programit në javën e orientimit dhe në mënyrë specifike gjatë prezantimit të secilës lëndë dhe syllabusit përkatës ku paraqitet ky informacion. Studentët janë të qartë për procedurat dhe kriteret që duhen ndjekur për punimin e temës së diplomës, kriteret antiplagjaturë dhe</p>



	<p>rezultatet e pritshme që duhet të arrijnë. Brenda një muaji nga data e fillimit të vitit akademik, Përgjegjësi i Departamentit u bën të njohur studentëve, të cilët diplomohen atë vit, programin e provimit të formimit ose të temave të diplomave, me anën e të cilave do të bëhet vlerësimi përfundimtar.</p> <p>Diploma “Bachelor” mund të fitohet duke dhënë një provim të përgjithshëm formimi, i cili është alternativë me mbrojtjen e një punimi diplome për studentët që kanë mesatare mbi 8 .</p> <p>Udhëheqësi i diplomës është përgjegjës për ndjekjen e studentit gjatë zhvillimit cilësor të punimit deri në përfundimin e tij.</p> <p><i>Evidencë 3.9.a, Procedura diploma Bachelor; Evidencë 3.9.b, Shembull procedura diploma Bachelor; Evidencë 3.11, Pyetjet e provimit të formimit; Evidencë H.1, Rregullore e programit të studimit Bachelor IE; Vizita në Institucion, takimi me studentët e programit.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Organizimi i institucionit në nivel informimi është në disa hallka paralele të cilat informojnë studentin. Studentët në mënyrë periodike informohen me anë të njoftimeve me anë të postës elektronike. Një rol të veçantë në informimin e studentëve jo vetëm për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve, por për çdo aspekt të lidhur me formimin e tyre, realizohet nga këshillimi me stafin administrativ në momentin që interesohen apo pranohen në programin e studimit. Një rol të veçantë në informimin dhe udhëzimin e studentëve e zë edhe Këshilli Studentor. AU nuk disponon një udhëzues të posaçëm për informimin e studentëve. Informimi i tyre bëhet përmes takimeve me stafin akademik dhe zyrën mbështetëse të studentëve.</p> <p><i>Vizita në Institucion, takimi me studentët.</i></p>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

<p>Standardi V.3 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Studentët aktualë, por edhe ata që parashikojnë të regjistrohen në këtë institucion, mund të marrin informacione të hollësishme në lidhje me strukturën akademike të ofruar nga institucioni. Gjatë javës së parë të vitit akademik, AU organizon “ditët orientuese”, gjatë të cilave stafi akademik, administrativ dhe Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët vihen në dispozicion të studentëve, dhe i informojnë ata mbi procedurat për mbarëvajtjen e studimeve të tyre: kalendari akademik, orari mësimor, frekuentimi, organizimi i klasave, grupeve, ambjentet mësimore etj.. Informacione të plota për këtë program studimi gjenden në faqen ueb.</p> <p>Këto informacione publikohen edhe në raportet vjetore të hartuara nga institucioni në përputhje me kriteret ligjore të raportimit të aktivitetit vjetor.</p>

	https://albanianuniversity.edu.al/sq/departamenti-i-inxhinierive/ <i>Evidencë 1.1a-1.1.d, Raportet Vjetore 2018-2021.</i>			
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Të dhëna specifike për modulet, lëndët dhe veprimtaritë formuese jepen në plan-programet e lëndëve që njoftohen prej pedagogëve të lëndëve. Të dhëna dhe materiale të lëndëve gjenden edhe në platformën online të institucionit ku studentët kanë akses në bazë përdorues/ fjalëkalim. Në DVV nuk është depozituar ndonjë dokument që shërben si udhëzues i posaçëm për studentët në lidhje me modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese, por ky informacion jepet kryesisht në web dhe nga takimi me studentët u konfirmua se ata informohen nga pedagogët përkatës së lëndëve në vijimësi të shkollimit të tyre. <i>Evidencë R. 4, Syllabuset e programit; Vizita në institucion, takimi me stafin akademik dhe takimi me studentët.</i>			
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	Studentët e regjistruar në këtë institucion kanë adresa të postës elektronike në domain të institucionit. Këto adresa përdoren në mënyrë periodike për të shpërndarë informacione nga zyra e karrierës mbi mundësitë e punësimit. Institucioni organizon çdo vit panairin e punës i cili për dy vitet e fundit është zhvilluar online në ZOOM si pasojë e kushteve të krijuara nga situata e pazakontë pandemike. Të dhëna të përditësuara gjenden edhe në faqen ueb të Zyrës së Karrierës dhe ALUMNI. https://albanianuniversity.edu.al/sq/zyra-e-koordinimit-dhe-mbeshtetjes-ndaj-studentit/ <i>Evidencë 5.1.b, Panair pune në ZOOM; Vizita në Institucion, takimi me sekretarinë mësimore dhe takimi me studentët.</i>			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Platforma kryesore ku shfaqet dhe përditësohet i gjithë informacioni për studentët është faqja ueb e institucionit. Studentët kanë qasje të përditësuar në të gjithë informacionin e nevojshëm për mbarëvajtjen e të gjithë procesit didaktik dhe jo vetëm. Në të gjenden dhe përditësohen të dhëna në lidhje me orari mësimor, plani mësimor, syllabuset e lëndëve, aktivitetet studentore, aktivitetet shkencore, njoftime etj. https://albanianuniversity.edu.al			
Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.	AU ka në përdorim një sistem sekretarie online për studentët. Aksesi në këtë sistem është në bazë të përdorues/fjalëkalim dhe mund të aksesohet nga kudo ku ka një qasje në internet.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.</p>	<p>Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për programin e studimit. Numri i studentëve të diplomuar për këtë program studimi, në katër vitet e fundit akademike paraqitet si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Për vitin akademik 2018-2019 janë diplomuar 28 studentë; – Për vitin akademik 2019-2020 janë diplomuar 28 studentë; – Për vitin akademik 2020-2021 janë diplomuar 49 studentë; – Për vitin akademik 2021-2022 nuk janë diplomuar ende studentë. <p><i>Aneks tabela - RVB - BSc. IEK – 2022, Tabela 23; Vizita në Institucion, takimi me Sekretarinë Mësimore.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>AU ka dhe përpunon të dhëna sasiore të regjistrimit/ diplomimit/ largimit/ transferimit, etj për studentët e këtij programi studimi. Referuar dokumentacionit të paraqitur nga IAL, të dhënat për regjistrimin dhe transferimin e studentëve në këtë program studimi, për tre vitet e fundit akademike, paraqiten si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Për vitin akademik 2018-2019, janë regjistruar 43 studentë për herë të parë, ndërsa nuk ka studentë të transferuar; – Për vitin akademik 2019-2020, janë regjistruar 42 studentë në total (23 për herë të parë dhe 19 të transferuar në vitin e dytë), me notë mesatare në hyrje 7.39; – Për vitin akademik 2020-2021, janë regjistruar 37 studentë në total (21 për herë të parë dhe 16 të transferuar (4 në vit të parë, 4 në vit të dytë dhe 8 në vit të tretë)), me notë mesatare në hyrje 7.32; – Për vitin akademik 2021-2022, janë regjistruar 41 studentë në total (29 për herë të parë dhe 12 të transferuar (2 në vit të parë, 5 në vit të dytë dhe 5 në vit të tretë)), me notë mesatare në hyrje 7.28. <p>Këto të dhëna gjenden edhe në regjistrin fizik të administruar nga sekretaria mësimore ku gjatë vizitës në institucion u konsultua regjistri përkatës, ku ishin të shënuara të gjitha, regjistrimet dhe transferimet.</p> <p><i>Aneks tabela - RVB - BSc. IEK – 2022, Tabela 23; Vizita në Institucion, takimi me Sekretarinë Mësimore, Përgjegjësit e Institucionit dhe programit.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Të dhënat statistikore disponohen nga institucioni edhe në përbushje të raporteve dhe udhëzimeve të kërkuara nga Drejtori apo seksione të veçanta në ministrinë përgjegjëse për arsimin. Gjithashtu, përdorimi i platformës së menaxhimit elektronik të të dhënave lejon një qasje të menjëhershme në performancën akademike të studentit. Të dhënat përfshijnë të gjithë jetën e studentit në AU, duke filluar që nga avancimi i tij akademik, të dhënat financiare në lidhje me institucionin, kërkesat e paraqitura për dokumentacione nga zyra të ndryshme brenda institucionit, etj.</p> <p><i>Evidencë 1.1.a-1.1d; Raportet Vjetore 2018-2021.</i></p>

<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe në veçanti gjatë takimit me sekretarinë mësimore, u vu re përdorimi efektiv dhe efikas i sistemit të menaxhimit elektronik të brendshëm. Në këtë sistem ruhen të gjitha të dhënat që kanë të bëjnë me studentët që nga regjistrimi i tyre deri në përfundim të karrierës studentore. Këtu, dokumentacionin përveçse i azhurnuar në formatin elektronik, për efekte ligjore ruhet edhe në formë shkresore (hard copy). Ku forma shkresore është lehtësisht e arritshme në arkivën përkatëse me të dhënat e menaxhimit të ruajtura në sistemin informatik.</p> <p><i>Vizita në Institucion, takimi me Sekretarinë Mësimore, Përgjegjësit e Institucionit dhe programit.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Bazuar edhe në vizitën në institucion dhe në veçanti takimi me përfaqësues të zyrës së karrierës, vihet re se AU i kushton një rëndësi të veçantë mbledhjes së të dhënave të studentëve të diplomuar. Kjo shërben edhe si një tregues i cilësisë dhe përdoret për përmirësimin e vazhdueshëm për të ofruar një program studimit që formon profesionist në fushat përkatëse.</p> <p>Këto të dhëna jepen në formë statistikore në raportet vjetore që hartohen nga institucioni dhe publikohen dhe në faqen ueb të AU.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Për vitin akademik 2018 - 2019, nga 28 studentë të diplomuar, janë të punësuar në total 13 studentë (46.4%), prej të cilëve (të punësuarve) 9 në përputhje me diplomën (69.2%) dhe 4 jo në përputhje me diplomën (30.8%); - Për vitin akademik 2019 - 2020, nga 28 studentë të diplomuar, janë të punësuar në total 13 studentë (46.4%), prej të cilëve 11 në përputhje me diplomën (84.6%) dhe 2 jo në përputhje me diplomën (15.4%); - Për vitin akademik 2020 - 2021, nga 49 studentë të diplomuar, janë të punësuar në total 20 studentë (40.8%), prej të cilëve 14 në përputhje me diplomën (70%) dhe 6 jo në përputhje me diplomën (30%). <p>Nga këto të dhëna vihet re se shkalla e punësimit të të diplomuarve është më pak se 50%, ku rreth 30% e gjithë të diplomuarve punësohen në lidhje me diplomën. Në raportet vjetore nuk ka ndonjë plan masash për përmirësimin e këtyre treguesve.</p> <p><i>GVJ rekomandon që DI të vlerësojë mundësitë që ka për të rritur numrin e të punësuarve në përputhje me diplomën, pasi është treguesi kryesor për cilësinë e produktit të këtij programi studimi. Edhe me rrjetin ALUMNI duhet të mbahen lidhje më të gjata që të referohen shembujt e suksesit në ndihmë të promovimit të programit të studimit.</i></p> <p><i>Aneks tabela - RVB - BSc. IEK – 2022, Tabela 23; Evidencë 1.1.a-1.1.d, Raportet Vjetore; Vizita në Institucion, takimi me Zyrën e Karrierës.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre

Kriteret**Vlerësimi i ekspertëve**

Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.

Bazuar në statutin e AU, prania e përfaqësuesve të studentëve është e sanksionuar në të gjitha organet kolegjiale. Në AU është i ngritur dhe funksionon edhe Këshilli Studentor i cili organizohet dhe kryen aktivitetin në bazë të statutit të tij. Përfaqësuesit e studentëve janë prezent në mbledhjet e departamentit dhe në grupet e vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit. Ata, gjithashtu, shprehin mendimet dhe kërkesat e tyre edhe përmes përfaqësuesve në Këshillin Studentor. Kryetari i Këshillit Studentor është pjesë e Senatit Akademik.

Evidencë 5.3, Proves verbal mbledhje departamenti; Evidencë H.2, Ngritja e GVB; Evidencë 1.2, Statuti i AU.

Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.

Studentët pëveç pjesëmarrjes në organet kolegjiale si Senati Akademik dhe disa prej komisioneve të përhershme të përcaktuara në Statutin e AU, janë pjesë e procesit të vlerësimit me anë të vlerësimeve periodike që plotësojnë si për stafin akademik ashtu edhe për institucionin dhe shërbimet e ofruara prej tij. Nga takimi me studentët u konfirmua se ndihen të përfaqësuar nga Këshilli Studentor dhe të mbështetur për problematikat që hasin në AU.

Evidencë 5.3, Procesverbal mbledhje departamenti; Evidencë H.2, Ngritja e GVB; Evidencë 1.2, Statuti i AU; Vizita në Institucion, takimi me studentët e programit.

Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.

Pas analizës së planit mësimor të ndryshuar të këtij programi studimi me planin e mëparshëm mësimor vihet re një ndarje korrekte të lëndëve në semestra dhe vite akademike, në kreditet përkatëse dhe orët në auditor dhe për studim individual të studentit.

Ndarja e orëve mësimore (në auditor dhe orë të studimit individual të studentëve) është si më poshtë:


Plani mësimor	Viti I (60 ECTS)		Viti II (60 ECTS)		Viti III (60 ECTS)		Total ore / (180 ECTS)
	Auditor	studim individual	Auditor	studim individual	Auditor	studim individual	
Pas ndryshimit	628	872	644	856	598	902	4500
	1500		1500		1500		
Para Ndryshimit	682	818	708	792	682	668	4350
	1500		1500		1350		

Tabelat e planeve mësimore, të paraqitura në tabelat 10 dhe 11, të përditësuara nga IAL, paraqesin ndryshimet për çdo lëndë me qëllim një ndarje korrekte të lëndëve në vite akademike, kreditet përkatëse dhe orët në auditor dhe për studim individual të studentit. Gjithashtu, vërehet një ndarje e orëve në auditor për aktivitetet formuese në rreth 10 orë/ECTS. *Në planin e ri mësimor, orët e studimit individual janë në çdo rast më shumë se gjysma e orëve totale, dhe*

	<p><i>sasia mesatare e orëve javore në auditor është më pak se 25, pra ndarja është bërë konform VKM Nr. 41.</i> Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike, ofruar nga Albanian University , ka lëndë të veçantë për praktikën profesionale, që zhvillohet në semestrin II të vitit të 3-të, me 4 ECTS. Në këtë program studimi nuk ka pasur raste të njohjes së studimeve të pjeshme.</p> <p><i>Aneks tabela - RVB - BSc. IEK - 2022_Tabela 10-11.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Bazuar në statutin e institucionit, studentët janë të përfshirë në të gjitha organet kolegjiale vendimmarrëse. Përtej përfaqësuesve të studentëve në organet e mësipërme, institucioni garanton mbledhjen e mendimeve, opinionëve dhe sugjerimeve të studentëve me anketimet periodike në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë.</p> <p><i>Evidencë 1.2, Statuti i AU; Aneks tabela - RVB - BSc. IEK - 2022_Tabela 10-11; Vizita në Institucion, takimi me studentët e programit.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Studentët e këtij programi studimi e pohuan edhe në takimin me ta gjatë vizitës në institucion se janë të informuar me procedurat dhe rregullat që mund të ndjekin nëse dëshirojnë të ankimojnë një vlerësim. Në përfundim të çdo semestri, studentët nëpërmjet anketimeve japin opinionin e tyre për të gjitha aspektet e jetës studentore brenda institucionit.</p> <p>Nga takimi me studentët në institucion u vu re një komunikim i hapur me stafin akademik dhe atë administrativ ç'ka sillte një qartësim të problematikave dhe një zgjidhje të tyre në mënyrë natyrale dhe frytdhënëse për studentët dhe institucionin.</p> <p><i>Vizita në Institucion, takimi me studentët e programit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<p>Standardi V.6 Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>AU, në përputhje me aktet rregullatore të tij ka ngritur strukturën Zyrën e Karrierës dhe Alumni, e cila në përputhje me parashikimet në rregulloren e saj informon studentët mbi mundësitë e punësimit, këshillon, mbështet dhe orienton studentët e AU, përfshirë dhe ata të programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Elektrike”. Kjo zyrë bashkëpunon me Zyrën e Koordinimit dhe mbështetjes së Studentëve, e cila mban kontakte dhe komunikim ditor me studentët.</p> <p>Çdo kërkesë e studentëve përcillet për ndjekje tek njësitë përkatëse për çështjet administrative dhe në Departamente për çështjet akademike.</p> <p><i>Evidencë H.1, Rregullorja mësimore e Bachelor IE; Evidencë 21, Statuti AU; Evidencë 80, Rregullore e Zyrës së Karrierës dhe Alumni; Evidencë 79, Rregullore e Zyrës së Koordinimit dhe mbështetjes së Studentëve.</i></p>

<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>AU ka ngritur strukturat specifike në institucion për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit, si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Zyrën e Karrierës dhe Alumni e cila informon në mënyrë të personalizuar në rast kërkese apo nevoje nga studentët, nëpërmjet email personal që ata pajisen si studentë në AU; 2. Zyrën e Koordinimit dhe mbështetjes së Studentëve, e cila në javën e parë të vitit akademik në bashkëpunim me Fakultetet organizon ditët e Orientimit për studentët e rinj në AU me informacion mbi çështjet administrative. Kjo zyrë ofron informacion dhe këshillim për studentët, monitoron progresin e tyre dhe koordinon zgjidhjen e ndonjë problemi që lidhet me procesin e mësimdhënies të programit të studimit në bashkëpunim me koordinatorin akademik të Departamentit. Gjithashtu studentëve ju jepen dhe informacione në formë udhëzuesish apo manualesh të publikuara dhe në faqen ueb përkatëse. <p><i>Evidencë 5.5, Rregullore e Zyrës së Karrierës dhe Alumni; Evidencë 5.4, Rregullore e Zyrës së Koordinimit dhe mbështetjes së studentëve.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>AU, nëpërmjet Zyrës së Karrierës dhe Alumni, ofron shërbimin e këshillimit të karrierës duke mirëpritur studentët në mënyrë të vazhduar, duke i orientuar qoftë në drejtim të përfundimit me sukses të procesit mësimor (krahas personelit akademik), por dhe në orientimin në tregun dhe vendet e lira të punës, mbështetjen si dhe këshillimin e nevojshëm në përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm dhe përgatitjen për intervistë. Mund të përmendim angazhimin e plotë të kësaj zyre në informimin e studentëve mbi klubet dhe kalendarin e aktiviteteve studentore, anëtarësimin e tyre në klube dhe pajisjen me kartën përkatëse. Kjo zyrë asiston studentët në programet e praktikës profesionale, që në muajin Mars kur hapen aplikimet për praktikë profesionale deri në përfundimin e tij. Praktika në programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Elektrike” realizohet gjatë semestrit të gjashtë, dhe është lëndë me 4 ECTS dhe i bëhet e ditur studentit në Rregulloren e programit të studimit, neni 27.</p> <p>Po nga kjo zyrë informohen studentët/ALUMNI për mundësitë e punësimit në fushën e tyre të studimit nëpërmjet email, Facebook, LinkedIn apo telefon. Kjo zyrë organizon aktivitete sociale që i japin të diplomuarve në AU mundësi të mbajnë lidhje dhe të krijojnë rrjete profesionale.</p> <p><i>Evidencë 1.1.a-1.1d, Raportet Vjetore 2018 -2021; Evidencë 5.4, Rregullore e Zyrës së Koordinimit dhe mbështetjes së Studentëve; Vizita në institucion, takimi me Zyrën e Karrierës dhe Alumni dhe takimi me studentët.</i></p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Zyra e Karrierës dhe Alumni, si pjesë të detyrave të saj, ndjek dhe mbështet studentët e diplomuar në programin e studimit. Nga kjo zyrë mbahen dhe të dhënat e punësimit real të tyre. AU deklaron një shkallë punësimi prej më pak se 50% për të diplomuarit e tij, të cilët janë të punësuar në tregjet vendore të punës. AU ofron praktika, rrjetëzim, panairë karriere dhe mundësi punësimi për studentët dhe të diplomuarit e tij në bashkëpunim me sektorët dhe industrinë në kuadër të Zyrës së Karrierës dhe Alumni. Kjo zyrë grumbullon, përpunon dhe regjistron të dhënat mbi punësimin dhe cilësinë e punësimit të</p>



	<p>tyre në raport me programin e studimeve. Këto të dhëna mbahen aktualisht dhe bëhen pjesë e ALUMNI, të cilat kjo zyrë ua vë në dispozicion studentëve, drejtuesve të Institucionit, bizneseve të interesuara për punësim të tyre, me konfirmimin paraprak nga studenti.</p> <p>Kjo zyrë ka krijuar një rrjet me të diplomuarit në rrjetet sociale AU, ku të gjithë të diplomuarit e interesuar bëhen pjesë dhe ky kanal shërben si një urë komunikimi për çdo aktivitet, njoftim apo mundësi punësimi, krahas komunikimit me emailt e të diplomuarve regjistruar në bazën e të dhënave të të diplomuarve, e cila përditësohet në vazhdimësi.</p> <p><i>Evidencë 5.1.a, Freelancer - Mundësi punësimi - 21 02 2020; Evidencë 5.1.b, Panair pune në Zoom - 28 05 2020; Evidencë 5.1.c, Si të punësohesh - Prof. Dr. S.V - 17.03.2022; Evidencë 5.2, Informacion mbi mundësinë e punësimit pranë kompanisë Noa Holding.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisët	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Albanian University, bazuar edhe në skemën organizative, ka të ngritur dhe funksionale Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila është e ndërvarur nga Rektorati dhe Senati Akademik tek i cili edhe raporton veprimtarinë e saj. Funksionimi i kësaj strukture bazohet në koordinimin e punës dhe të dhënave nga tre organe vartëse: Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Komisioni i Zhvillimit të Kurrikulave dhe Komisioni i vlerësimit institucional. Funksionimi i këtyre organeve garanton sistemin e brendshëm të Sigurimit të Cilësisë në AU. Funksionimi i këtyre organeve sanksionohet në rregulloret përkatëse të cilat janë publike dhe të afishuara në faqet ueb përkatëse https://albanianuniversity.edu.al/wp-content/uploads/2020/07/Organograma-me-ngjyra-Perfundimtare-2021.png
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e	Bazuar në strukturën organizative të institucionit, ekziston NjSBC i cili vepron si një organ kolegjal me të paktën 5 (pesë) anëtarë. Gjatë vizitës në institucion u realizua edhe takimi me anëtarë të kësaj njësie. Në përbërjen e këtij komisioni është të paktën një përfaqësues i çdo fakulteti me të paktën

<p>vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>gradën shkencore “Doktor”. Në këtë komision përfaqësohet edhe stafi administrativ, studentët, si dhe një ekspert i jashtëm kur shihet e nevojshme.</p> <p>https://albanianuniversity.edu.al/wp-content/uploads/2020/07/Organograma-me-ngjyra-Perfundimtare-2021.png</p> <p><i>Vizita në Institucion, takimi me Zyrën e NJSBC.</i></p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>NjsBC në AU koordinon realizimin e procesit të vetëvlerësimit të institucionit nëpërmjet instrumentave e mekanizmave dhe akteve të brendshme rregullatore. Trajnimi i stafit akademik është një element i rëndësishëm i politikave që AU ndjek për ruajtjen dhe rritjen e mëtejshme të sigurimit të cilësisë. Zakonisht në fillim të vitit akademik, por edhe gjatë tij, realizohen trajnime me personelin akademik, edhe me lektorë të huaj, për çështje që lidhen me teknologjitë e mësimdhënies, metodat bashkëkohore të mësimdhënies, etj. Instrumentat e AU, si pyetësorët me studentët, stafin akademik, fokus grupet, etj. shërbejnë për marrjen e një feedback-u me qëllim ndërhyrjen dhe përmirësimin e cilësisë nëse është e nevojshme.</p> <p>Sigurimi i jashtëm i cilësisë në nivel institucioni dhe programi studimi organizohet në mënyrë periodike nga ASCAL. Raportet e vlerësimit të jashtëm të cilësisë si për institucionin ashtu edhe për program studimi janë publike në faqen ueb të institucionit.</p> <p><i>Evidencë 3.6.a, 3.6.b, Agjenda të Trajnimit të stafit akademik; Evidencë 6.7.a-6.7.d, Fokus grupe.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjsteve përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>NjsBC koordinon realizimin e procesit të vetëvlerësimit të institucionit nëpërmjet mekanizmave (anketimi i studentëve 2 herë në vit, fokus grupet etj) dhe akteve të brendshme rregullatore. Bazuar në sugjerimet dhe gjetjet e këtij komisioni, hartohen politika të brendshme për rritjen e cilësisë në të gjitha aspektet e jetës akademike, administrative dhe sociale të institucionit dhe stafit, të cilat janë sanksionuar në rregullore, strategjinë institucionale të zhvillimit dhe politika të brendshme të institucionit për përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programeve të studimit të ofuara që publikohen dhe në faqen web të AU.</p> <p><i>Evidencë 1.5.a, Plani strategjik institucional 2017-2022; Evidencë 1.5.b, Plani i masave Rektorati 2020 për realizimin e planit strategjik institucional 2017-2022.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>


<p>Standardi VI.2 Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin</p>	<p>NjsBC dhe Komisioni i vlerësimit Institucional, në rastin e vlerësimit të një programi studimi, koordinon procesin e rishikimit duke filluar në nivel</p>

<p>e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<p>departamenti. Bazuar në ndryshimet e propozuara dhe sugjerimet e paraqitura në nivel departamenti, rezultatet përcillen në njësinë kryesore përkatëse (fakultet). AU ka procedura të qarta për propozimet për ndryshime apo rishikime të programeve të studimit ekzistuese. Vendimi i departamentit dhe i Dekanit përkatës, bazuar në procedurat e brendshme, i përcillen Komisionit të Zhvillimit të Kurrikulave i cili shqyrton propozimet në përputhshmëri me objektivat e zhvillimit të institucionit. Pjesë e këtij komisioni bëhen edhe specialistë të fushës jashtë AU.</p> <p>Nga ana institucionale, propozimet e Komisionit të Zhvillimit të Kurrikulave i përcillen Komisionit të Vlerësimit institucional/NJSBC. Mbas shqyrtimit në të gjitha këto komisione, vendimi përfundimtar për aprovimin e ndryshimeve shqyrtohen në Senatin Akademik bazuar në relacionet përkatëse të përcjella nga të gjitha zyrat dhe komisionet e përfshira në këtë proces.</p> <p><i>Evidencë 6.10, Rregullore e NJSBC; Evidencë 6.11, Ngritja e grupeve të ekspertëve për rishikim kurrikulash.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Bazuar në DVV, vizitën në institucion, veçanërisht takimi me pedagogët dhe studentët, GVJ konstatoi që në mënyrë periodike në fund të çdo semestri studentët plotësojnë anketime në lidhje me të gjitha aspektet e jetës akademike dhe jo vetëm, në institucion. NJSBC dhe Zyra e sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Komisioni i Zhvillimit të Kurrikulave, etj. kanë mekanizma të qarta për të vlerësuar në mënyrë periodike të gjitha aspektet akademike, administrative dhe sociale të organizuara nga institucioni dhe për institucionin të identifikuar dhe në manualin e sigurimit të cilësisë. Të dhënat kryesore mbledhen nga proceset e anketimeve të cilat përpunohen për të nxjerrë të dhëna statistikore në funksion të përmirësimit të cilësisë.</p> <p><i>Evidencë 6.7.a-6.7.d, Fokus grupe 2019-2022; Evidencë 6.10, Rregullore e NJSBC; Evidencë 6.11, Ngritja e grupeve të ekspertëve për rishikim kurrikulash; Vizita në Institucion, takimi me pedagogët dhe studentët.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>AU kryen analiza semestrale dhe vjetore për ecurinë e programeve të studimit duke i rishikuar ato në kontekstin e kërkesave të tregut. Rezultatet e anketimeve përbëjnë elementët kyç në vlerësimin e një programi studimi. Anketimet që përdoren nuk janë vetëm ato të përpiluara nga studentët aktualë, por edhe ato të plotësuara nga ish studentë në kuadër të strukturës alumni. Analiza e anketimeve shërben për vlerësimin dhe orientimin e programit të studimit drejt nevojave të tregut të punës kombëtar dhe ndërkombëtar në varësi të profilit të programit të studimit.</p> <p><i>Evidencë 6.7.a-6.7.d, Fokus grupe 2019-2022; Evidencë 5.5, Rregullore e Zyrës së Karrierës dhe Alumni.</i></p>
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Raportet e brendshme të cilësisë të hartuara nga NJSBC dhe përpunimi i të dhënave të anketimeve por jo vetëm, analizohen në të gjitha hallkat vendimmarrëse të institucionit. Raportet e hartuara dhe vlerësimet përkatëse përcillen në formë hierarkike: Departament > Dekanat > Komisioni për Zhvillimin e Kurrikulave > Komisioni i vlerësimit institucional > Senati Akademik.</p> <p>Detajet e raporteve janë specifike dhe të përmbledhura sipas hallkës së zinxhirit hierarkik që do të kryejë analizën. Vlerësime specifike për lëndë të</p>



	<p>caktuara apo aspekte të veçanta të tyre analizohen në detajen në nivel departamenti, analiza dhe vlerësime më specifike në nivel program studimi dhe staf akademik realizohet në nivel dekanati. Hallkat e tjera analizojnë rezultatet e vlerësimit në kontekstin e programit specifik të studimit si dhe në atë të zhvillimit institucional. Raportet e përmbledhura, edhe në kuadër të ruajtjes së privatësisë së të dhënave, bëhen publike të përmbledhura apo të përpunuara në faqen zyrtare të institucionit.</p> <p><i>Evidencë 1.1.a- 1.1.d, Raporte Vjetore 2018-2022, S.1.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>	<p>Raportet e vlerësimit individual për secilin pedagog/staf akademik përmbajnë të gjithë treguesit e nevojshëm apo parametrat vlerësuese të dobishme për vetë stafin që të përmirësojë në vijim, si aftësitë në mësimdhënie, komunikimi me studentët, transparenca e vlerësimeve të studentëve gjatë vitit, përdorimi i teknologjisë në funksion të mësimdhënies etj. Gjatë vizitës në institucion na u konfirmua se raportet e vlerësimit për staf akademik efektiv të këtij programi studimi janë realizuar për semestra dhe lëndë të ndryshme për të njëjtin pedagog, me objektivitet të analizës dhe raporteve përkatëse, të veçantë dhe me pika të ndryshme për tu analizuar lëndë pas lënde.</p> <p><i>Evidencë 1.1.a- 1.1.d, Raporte Vjetore 2018-2022, S.1; Vizita në Institucion, takimi me zyrën e NJSBC.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi VI.3 Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Zyra përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë në AU, në mënyrë periodike dhe të vazhduar, realizojnë vlerësimin e brendshëm të këtij programi studimi. Raportet e hartuara kryesisht në nivel departamenti bazohen në përpunimin e anketimeve studentore për çdo lëndë dhe çdo pedagog të angazhuar në procesin e mësimdhënies përkatëse. Përpunimi i këtyre të dhënave kryhet në formë të automatizuar dhe statistikore nga sistemi i menaxhimit të brendshëm elektronik të informacionit. Ndërtimi i raporteve dhe vlerësimeve përkatëse bazohet në direktiva të brendshme të njohura nga të gjithë punonjësit e institucionit.</p> <p><i>Evidencat 6.8.a-6.8.e, 6.9, Rezultatet e pyetësorëve drejtuar studentëve/stafit akademik.</i></p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në rregulloren institucionale, i gjithë procesi i raportimit, vlerësimit dhe veprimit bazohet në të njëjtën procedurë institucionale dhe nuk është specifik për këtë program studimi. Ndër kriteret specifike që përdoren nga institucioni në vlerësimin e brendshëm është edhe numri dhe cilësia e botimeve/publikimeve shkencore të realizuara nga stafi brenda një periudhe të caktuar vjetore.</p>




	<i>Evidencë 1.3, Rregullore e AU; Evidencë 1.7, Rregullore e FSHAE në AU.</i>			
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, teste lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në teste ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Burimi parësor i mbledhjes së të dhënave nga institucioni për vlerësimin e të gjithë procesit didaktik bazohet kryesisht në anketime të plotësuara nga studentët por edhe nga vetë stafi akademik. Në rast ankesash apo vlerësime të ulëta të stafit në kriteret e vlerësimit të cilësisë, organet vendimmarrëse kanë mekanizma të përcaktuara qartë për ndjekjen dhe përmirësimin e cilësisë në tërësi. Në rast vlerësimi të ulët në mësimdhënie apo në provime, drejtuesi i njësisë bazë (përgjegjës departamenti) dhe ai i njësisë kryesore (dekan) zhvillojnë vëzhgime në klasë në formë të leksioneve të hapura <i>Evidencë 1.2, Statuti i AU; Evidencë 2.2, Rregullore Departamenti.</i>			
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	Institucioni, përveç përdorimit të teknikave të anketimeve dhe përpunimit statistikor të tyre, përdor edhe metoda motivuese dhe vlerësuese të stafit akademik në lidhje me performancën e tyre në kërkim shkencor apo angazhimin në projekte dhe punë administrative. Pjesëmarrja në aktivitetet e tjera përveç atyre didaktike vlerësohen pozitivisht si motivuese të punës në grup dhe frymës bashkëpunuese brenda institucionit. Kjo vihet re edhe në përfshirjen e studentëve (nivel institucional) në projektet e institucionit në lidhje me kërkimin shkencor, si mjet për vlerësimin e dijeve dhe kompetencave të përfuara nga ky program studimi. Për programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Elektrike, numri i studentëve të përfshirë në kërkim shkencor ndërkombëtar aktualisht është 0, por ka aktivizim të studentëve në konferenca studentore që AU ka organizuar e vetme ose në bashkëpunim me CIT. <i>GVJ sugjeron që Departamenti të shtojë përpjekjet përmes punës së diferencuar me studentët që të arrijë përfshirjen e tyre në aktivitetet shkencore ndërkombëtare së bashku me stafin akademik.</i> Rrjeti Alumni, i ngritur në AU synon të mbledhë të dhëna në lidhje me cilësinë e procesit didaktik por edhe për të kuptuar trendin dhe nevojat e tregut të punës dhe formimin që mungon apo duhet forcuar në aspektin didaktik. Nga IAL hartohen raporte të arritjes të diplomuarve në tregun e punës, që publikohen dhe në faqen web të IAL. <i>Evidencë 5.5, Rregullore e Zyrës së Karrierës dhe Alumni; Evidencë, Minuta takimi AU.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në	Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë si dhe strukturat nën varësinë e saj, kryejnë të gjithë aktivitetin e tyre të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë

<p>politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>bazuar në rregullore dhe politika të brendshme të cilat janë publike për të gjithë stafin. Për të paraqitur një vlerësim sa më objektiv të cilësisë dhe monitorimit të saj, në përbërjen e grupit të përhershëm për rishikimin e kurrikulave, është i angazhuar edhe një ekspert publik i cili nuk është pjesë e stafit të Universitetit. Në politikat e rritjes së cilësisë edhe në nivel ndërkombëtar, insitucioni motivon zhvillimin e projekteve dhe publikimeve shkencore, për të cilat stafi motivohet edhe me mbështetje financiare.</p> <p><i>Evidencë 6.11, Ngritja e grupeve të ekspertëve për rishikimin e kurrikulave 2019.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe takimet u vu re se stafi administrativ ka detyra të ndara qartë dhe frymë bashkëpunuese mes tyre. Bazuar në politikat dhe aktet e brendshme rregullatore, detyrat janë të ndara për çdo strukturë përbërëse të institucionit, jo vetëm ato akademik por edhe administrative.</p> <p><i>Evidencë H.1, Rregullore mësimore Beh IE; Evidencë, Minuta takimi AU.</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në vlerësimin e brendshëm të cilësisë, institucioni ndjek një strukturë hierarkike të vlerësimit dhe analizës së raporteve të hartuara nga njësitë përgjegjëse për sigurimin e cilësisë. Raportet e hartuara dhe vlerësimet përkatëse përcillen në formë hierarkike Departament > Dekanat > NJSBC >Komisioni për vlerësim institucional/Rektorat >Senat Akademik. Në këtë formë, të gjitha hallkat administrative, akademike dhe vendimmarrëse janë të përfshira në procesin e vlerësimit të cilësisë. Gjithashtu, në NjsBC ka të paktën një anëtar të çdo njësie kryesore (Fakultet), përfaqësohet stafi administrativ me të paktën dy anëtare, një përfaqësues i studentëve dhe një ekspert i jashtëm kur shihet e nevojshme.</p> <p><i>Evidencë 1.2, Statuti i AU; Evidencë 6.4, Strategjia 3 vjeçare për sigurimin e cilësisë në AU.</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, dhe në veçanti në takimin me Dekanin dhe përfaqësuesin e departamentit u vlerësua respektimi i fushave të ekspertizës për secilin prej anëtareve të stafit akademik dhe administrativ. Në proceset sqaruese/ udhëzuese dhe të vlerësimit të brendshëm merrret gjithmonë opinioni dhe vlerësimi i stafit më me eksperiencë apo përgatitje në fushën përkatëse pa diskriminime të pozicionit administrativ që ka në institucion. Gjithashtu, në hartimin e raporteve apo edhe në interpretimin e të dhënave institucioni bazohet në politikat e sigurimit të cilësisë.</p> <p><i>Evidencë 1.2, Statuti i AU; Evidencë 6.4, Strategjia 3 vjeçare për sigurimin e cilësisë në AU; Vizita në Institucion, takimi me Dekanin dhe përfaqësuesin e departamentit.</i></p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vjera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, dhe në veçanti në takimin me stafin akademik, vihet re një frymë bashkëpunimi edhe me stafin akademik të ftuar në lidhje me procesin e përmirësimit të programeve të studimit dhe të syllabuseve të lëndëve. Gjithashtu, si pjesë e vlerësimit të brendshëm të cilësisë, Komisionit i vlerësimit institucional ka në përbërjen e tij një ekspert të jashtëm kur shihet e nevojshme. Përfshirja e ekspertëve të jashtëm në proceset e vlerësimit është në nivel institucioni dhe jo në nivel programi studimi.</p>

	<i>Evidencë 1.2, Statuti i AU; Evidencë 6.4, Strategjia 3 vjeçare për sigurimin e cilësisë në AU; Vizita në Institucion, takimi me stafin akademik.</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe nga hulumtimi në faqen web të institucionit, vihet re një transparencë në publikimin e informacioneve të dobishme për studentët në lidhje me programet e studimit, strukturën akademike, politikën dhe strategjinë e AU përmes publikimit të dokumentave të rëndësishëm si Statuti, Rregullorja e AU etj. Ka informacion publik për stafin dhe të gjithë të interesuarit, si psh. të dhëna statistikore mbi numrin e studentëve të pranuar, diplomuar apo larguar për çdo vit dhe për çdo program studimi. Nga IAL janë bërë publike trajnimet e ndryshme të realizuara në kuadër të trajnimeve të stafit dhe ato të realizuara në kuadër të projekteve. <i>GVJ konstaton se nga IAL nuk janë bërë publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit aktivitetet në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit.</i></p> <p><i>GVJ rekomandon që Albanian University të bëjë publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit aktivitetet në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit.</i></p> <p><i>Evidencë: https://albanianuniversity.edu.al</i></p>
Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	<p>Të dhënat e mbledhura dhe përpunuara në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë, në tërësinë e tyre publikohen të përmblidhura dhe në formë statistikore, në raportet vjetore të AU, çka garanton mos cënimin e të dhënave personale në përputhje të plotë me Ligjin Nr. 9887, datë 10 Mars 2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”. Përdorimi i të dhënave personale të personelit akademik, studentëve apo çdo të dhënë personale, kryhet konform rregulloreve të brendshme institucionale dhe në varësi të hierarkisë të stafit në institucion. Të dhënat janë të aksesueshme si raporte në sistemin e brendshëm ku qasja në nivele të ndryshme të të dhënave garantohet nga privilegjet që gjithsecili ka në këtë sistem, çka garanton privatësinë dhe etikën e përpunimit të këtyre të dhënave. AU në përfundim të çdo viti akademik në përputhje me udhëzimin Nr. 5 dt. 18.02.2018, dërgon pranë MAS raportin vjetor të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore – shkencore të Institucionit, si dhe e bën publike për të gjithë të interesuarit në faqen web.</p> <p><i>https://albanianuniversity.edu.al/sq/sigurimi-i-brendshem-i-cilesise/.</i></p>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	<p>Bazuar në gjetjet dhe raportet e hartuara nga Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, analizohen nga organet kolegjiale sikurse janë Senati akademik, Dekanati apo edhe në nivel departamenti. Të gjitha këto hallka vendimmarrëse bazuar në këto raporte, hartojnë plane veprimi të detajuara me afatet kohore të realizimit dhe zyrat dhe stafi përgjegjës për realizimin por edhe ndjekjen</p>



	<p>dhe raportimin e realizimeve. Nga IAL hartohen raporte të arritjes të diplomuarve në tregun e punës, që publikohen dhe në faqen web të IAL. Raporti vjetor i departamentit përfshin edhe të dhëna mbi masat e marra nga planveprimi i vitit të kaluar dhe planin e veprimit për vitin e ardhshëm akademik.</p> <p><i>Evidencë 1.1.a-1.1.d, Raportet vjetore DI për v.a 2018-2019 -2021-2022 (S.I); Vizita në Institucion, takimi me NJSBC.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në kuadër të rritjes së vazhdueshme të cilësisë, Albanian University organizon evente trajnuese si për stafin akademik ashtu edhe atë administrativ. Gjithashtu vihet re një staf me eksperiencë dhe i konsoliduar në përbërjen e Njësisë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC). Në këtë njësi ka staf të angazhuar që në vitin akademik 2018-2019 e në vijim sikurse pjesa më e madhe është e angazhuar në këtë funksion që nga viti akademik 2018-2019.</p> <p><i>Evidencat 6.3.b-6.3.e, Përfaqësuesit e ZSC në DI për v.a 2018-2019-2021-2022; Aneks tabela - RVB - BSc. IEK – 2022.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se Albanian University ka përfshirë stafin akademik dhe studentët në proceset e informimit, ndërgjegjësimit të tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë e cilësisë së programeve të studimit nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • pjesëmarrjes së tyre në NJBSC; • pjesëmarrjes në GVB ad-hoc të programeve të studimit në proces akreditimi; • në javën e orientimit në fillim të vitit akademik, • dhe në mënyrë të tërthortë dhe me procesin e pyetorëve të studentëve. <p><i>Por nuk ka organizuar veprimtari periodike trajnuese dhe informuese për këtë qëllim. GVJ rekomandon që IAL duhet të organizojë veprimtari periodike trajnuese dhe informuese me personelin dhe studentët për t'i informuar për nevojën e ndërgjegjësimit të tyre për rëndësinë e pjesëmarrjen aktive në proceset e sigurimit të cilësisë dhe përmirësimin e vazhdueshëm dhe afatgjatë të cilësisë në programet e studimit, përfshi programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Elektrike”.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor “Inxhinieri Elektrike” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Albanian University”

Pikat e forta dhe afirmime:


1. Institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi të reja në drejtim të bashkëpunimit akademik dhe profesional brenda dhe jashtë vendit.
2. Mbulimi i lëndëve të programit të studimit me personel akademik, në përputhje me fushën e ekspertizës.

Pika të dobëta:

1. Literatura e detyrueshme e programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Elektrike”, në disa prej lëndëve të programit, është jo e 5 viteve të fundit dhe numri i titujve në bibliotekë për këtë program studimi nuk është i mjaftueshëm [**Standardi II.4, kriteri 6; Standardi III.3, kriteri 4 dhe 5; Standardi IV.4, kriteri 2 dhe 5**].
2. Personeli akademik efektiv rezulton i mbingarkuar me orë mësimore, duke mos ndihmuar kështu procesin e rritjes së efektivitetit të mësimdhënies e mësimnxënies, si dhe jo të gjithë titullarët e lëndëve i përkasin kategorisë “Profesor”, sikurse kërkuar nga parashikimet ligjore në fuqi [**Standardi II.5, kriteri 2; Standardi IV.2, kriteri 4**].
3. Mjediset dhe infrastruktura e vënë në dispozicion nga AU në funksion të procesit mësimor dhe shërbimeve të tjera për studentët e programeve të Departamentit të Inxhinierive, përfshirë këtë program studimi, rezulton jo në përputhje me standardet shtetërore të përcaktuara në Vendimin Nr. 418, datë 10.05.2017 [**Standardi III.3, kriteri 1; Standardi IV.3, kriteri 1**].
4. Financimi i programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Elektrike” bëhet kryesisht prej tarifës së studimit dhe shumë pak prej granteve e projekteve ku Institucioni përfshihet [**Standardi IV.6, kriteri 5**].
5. Shkalla e punësimit të të diplomuarve në përputhje me diplomën në këtë program studimi nuk është shumë e lartë, si e tillë nuk mund të jetë një avantazh që ky program studimi të tërheqë më shumë studentë [**Standardi V.4, kriteri 5**].

Rekomandime:

1. Institucioni, të përditësojë literaturën e detyrueshme për lëndët e këtij programi studimi, si dhe të pasurojë e përditësojë bibliotekën me tituj të rinj dhe revista teknike bashkëkohore, në funksion të këtij programi studimi.
2. Institucioni, të marrë masa për uljen e ngarkesës së personelit akademik efektiv aktual, në mënyrë që të garantohet një mësimdhënie dhe mësimnxënie sa më cilësore, si dhe të caktojë si titullarë të lëndëve personel akademik të kategorisë “Profesor”.



3. Institucioni, të marrë masa për sigurimin e sipërfaqes së shfrytëzueshme për programet e studimit në fushën “Inxhinieri dhe teknologji”, në përputhje me normativën e parashikuar në Vendimin Nr. 418, datë 10.05.2017.
4. Institucioni, të rrisë përpjekjet për gjetjen e burimeve të tjera për financimin e programit të studimit, përveç tarifave studentore, sidomos prej granteve në projekte kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare, e cila do të rriste jo vetëm qëndrueshmërinë financiare të AU, por do të përmirësonte ndjeshëm edhe cilësinë e mësimdhënies dhe rankimin e IAL në plan kombëtar.
5. Institucioni, të angazhohet më tepër në shfrytëzimin e bashkëpunimeve aktuale, apo krijimin e bashkëpunimeve të reja me punëdhënës në fushën e këtij programi studimi, me qëllim rritjen e numrit të të diplomuarve të punësuar në përputhje me diplomën, si një tregues kryesor për cilësinë e produktit të këtij programi studimi.
6. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të bëjë publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit aktivitetet në kuadër të sistemit të sigurimit të brendshëm të cilësisë për programin e studimit.
7. Institucioni, të shtojë përpjekjet në mënyrë që të sigurojë një përfshirje më të madhe të stafin akademik dhe studentëve të këtij programi studimi, në aktivitete ndërkombëtarë të kërkimit shkencor (botime, konferenca, mobilitete).


Conclusion of the Evaluation of the first cycle study program Bachelor in “Electric Engineering”, of HEI “Albanian University” Private University

Strengths and Affirmations:

1. The institution has signed new cooperation agreements in terms of academic and professional cooperation inside the country and abroad.
2. Covering the subjects of the study program with academic personnel, in accordance with the field of expertise.

Weaknesses:

1. The mandatory literature of the Bachelor study program in “Electrical Engineering”, in some of the subjects of the program, is not of the last 5 years and the number of titles in the library for this study program is not sufficient [**Standard II.4, criterion 6; Standard III.3, criterion 4 and 5; Standard IV.4, criterion 2 and 5**].
2. The effective academic staff is overloaded with teaching hours, thus not helping the process of increasing the effectiveness of teaching and learning, as well as not all subject holders belong to the "Professor" category, as required by the legal provisions in force [**Standard II.5, criterion 2; Standard IV.2, criterion 4**].
3. The environments and infrastructure made available by AU in function of the learning process and other services for the students of the Department of Engineering programs, including this study program, are not in accordance with the state standards defined in




Decision No. 418, dated 10.05.2017 [**Standard III.3, criterion 1; Standard IV.3, criterion 1**].

4. The financing of the Bachelor study program in "Electrical Engineering" is made mainly from the study fee and very little from the grants and projects where the Institution is involved [**Standard IV.6, criterion 5**].
5. The employment rate of graduates in accordance with the degree in this study program is not very high, as such it cannot be an advantage for this study program to attract more students [**Standard V.4, criterion 5**].

Recommendations:

1. The institution should update the mandatory literature for the subjects of this study program, as well as enrich and update the library with new titles and contemporary technical magazines, in the function of this study program.
2. The institution should take measures to reduce the workload of the current effective academic staff, in order to guarantee the highest quality teaching and learning, as well as appoint academic staff of the "Professor" category as subject holders.
3. The institution should take measures to ensure the usable area for study programs in the field "Engineering and technology", in accordance with the norms provided in Decision No. 418, dated 10.05.2017.
4. The institution should increase its efforts to find other sources for financing the study program, in addition to student fees, especially from grants in national and international scientific research projects, which would not only increase the financial sustainability of AU, but would significantly improve the quality of teaching and the ranking of HEI at national level.
5. The institution should be more engaged in the use of current collaborations, or the creation of new collaborations with employers in the field of this study program, in order to increase the number of graduates employed in accordance with the degree, as a main indicator for the quality of product of this study program.
6. The Internal Quality Assurance Unit should make public to students and all interested parties the activities within the internal quality assurance system for the study program.
7. The institution should increase its efforts in order to ensure a greater involvement of the academic staff and students of this study program in international scientific research activities (publications, conferences, mobility).



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

